



**SI TË BËHET E
SUKSESSHME EKONOMIA
NË GOSTIVAR?**

Skopje, July 2006

Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politike

BCE ECB EZB EKT EKP 2002

Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politike është institut hulumtues i pamvarur dhe jo-profitabil themeluar në mars të vitit 2004. QHKP përbëhet nga hulumtues lokal si dhe konsultantë të jashtëm të cilët janë në kontakt të afërt me organizatën. Organizata ofron analiza politike themelore dhe provocative të temave më aktuale. QHKP nuk ka “agjendë të fshëhur”, por punon në drejtim të promovimit të demokracisë dhe transformimit ekonomik të vendit. Ajo nuk ka përkatësi politike apo partiake, as është në lidhje me ndonjë organizatë tjetër. QHKP zhvillon stilt të ri të analizave politike dhe shërben si forum për qytetarët e rinj që ta zhvillojnë dhe tregojnë diturinë e tyre dhe shkathtësitë në lidhje me hulumtimin bazuar në dëshmi dhe analizat politike. Pika filluese nga e cila QHKP afrohet në tema të caktuara është principiele. Organizata, paqen dhe stabilitetin i konsideron si princip të parë që duhet të sundojë në vendet e Ballkanit dhe beson se qëllimi kryesor politik i Republikës së Maqedonisë është integrimi në Unionin European.

Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politike është formuar prej ekipit multi-disciplinar duke bashkuar njerëz me përvojë të ndryshme dhe interesa profesionale dhe hulumtuese dhe përfshin përvojë të konsiderueshme për mënyrën në të cilën funksionon procesi politik maqedon. Anëtarët e QHKP-së janë të specializuar në menaxhimin e projekteve dhe hulumtume politike dhe analiza, treningje dhe ndërtim të kapaciteteve, si dhe këshilla politike. Ata janë të aftë ta kordinojnë planifikimin e aktiviteteve dhe zbulimeve (informatat, të dhënat) në mënyrë fleksibile dhe efektive, jep analiza relevante dhe përkatëse në lidhje me realitetin politik dhe ekonomik, po në të njëjtën kohë i kushton vëmendje të veçantë mobilizimit përkatës të resurseve si dhe mbikqyrje të zhvillimit të projektit.

Departamentat kryesore të QHKP-së janë të specializuar për hulumtim dhe analiza politike, dizajnimin i projekteve dhe menaxhimin i të njëjtave, zhvillim rajonal/lokal, trening dhe ndërtim i kapaciteteve, këshilla politike. Ekipi i QHKP-së është në gjendje të ofrojë shërbime të plota consultative dhe praktike në kornizat e projekteve të dhëna.

Our Partners

The German Marshall Fund of the United States of America

Olof Palme International Center

Foundation Open Society Institute Macedonia.

Përmbajtje

Hyrje	5
CHAPTER 1 Gostivari-zhvillimi gjatë kohës së socializimit	9
CHAPTER 2 Tranzicioni dhe gjendja e tashme -zhvillim i mikro sektorit	17
CHAPTER 3 The Key Role of the Emigrants	33
CHAPTER 4 Si të ringjallet ekonomia në Gostivar-krijimi i “kampionëve” dhe shëndrimi i mangësive në përparësi	45
CHAPTER 5 Decentralizimi dhe roli i pushtetit lokal -rekomandime	48
Rekomandime	57

Hyrje

Ekzistojnë shumë faktorë, politika dhe institucionet që e përcaktojnë në shumë sende zhvillimin e ndryshëm në vende të ndryshme. Finlanda është në majë të rejting listës së konkurrencës në botë, sepse ka rrethinë biznesi novativ më të mirë. Kina dhe India janë në mes¹; por ato kanë potencial të madh për zhvillim me zmadhimin direkt të investimeve të huaja në sektorët për ekspertizëm dhe teknologji. Njëri nga faktorët kryesor për zhvillim është mjedisi makroekonomik. Faktor tjetër është cilësia e arsimit, përfitimi me aftësitë e nevojshme dhe niveli i trajnimit të fuqisë punëtore. Zvogëlimi drastik i shpenzimeve për transport dhe komunikim kompanive botërore u mundësoi ta plasojnë prodhimin e vet në vende të cilat janë të afta të afrojnë kuadër të aftë dhe fuqi punëtore të llirë si dhe stabilitet ekonomik dhe politik. Këto vende bëhen më konkurBEse.

Në lidhje me këtë po e parashtrijmë edhe pyetjen: **çfarë e bën një vend, një rajon, një qytet konkurBEs?** Vallë Maqedonia është konkurente, a mund në të ardhmen të bëhet më konkurente? Në ç'mënyrë decentralizimi dhe europejanizimi, si dy procese paralele, ndikojnë mbi zhvillimin ekonomik të vendit; a mundet ata të krijojnë mjedis i cili është stabil, si nga ana politike ashtu edhe në atë sociale dhe i cili do ta nxisë zhvillimin ekonomik?

Sipas raportit më të ri për zhvillimin botëror, Maqedonia gjendet në vendin e 85 mes 100 ekonomive botërore. Prej 17 dhjetorit 2005 Maqedonia është vend kandidat për antarësim në Bashkimin European. Prej një korikut 2005 zyrtarisht është vend i decentralizuar ku komunat kanë liri midis të tjerave të krijojnë politikë për zhvillimin ekonomik lokal.

Zhvillimi i ekonomisë maqedonase mund të definohet si i kushtëzuar nga faktorë². Ka stabilitet makroekonomik³, shkallë të lartë të papunësisë⁴ dhe

¹ Në raportin nga viti 2005 për konkurrentë në botë Kina është në vendin e 49, a India në vendin e 50

² Si çështë definuar në tabelën 1

sektor i madh i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme⁵. Mirëpo, fuqia punëtore është kryesisht e paarsimuar⁶ dhe niveli i investimeve të huaja direkte është më i ulët në rajonin⁷. Proçesi i integritimit në BE ishte fuqia kryesore lëvizëse për arritje demokratike, politike dhe stabilitet makroekonomik⁸. Përvojat nga vendet e Europës së mesme dhe lindore të cilat u bënë vende-anëtare të BE në vitin 2004 tregojnë se “ato kanë qënë më të mirë nga vendet themelBEse të BE (BE 15) me rritje vjetor mesatare ekonomike prej 3,4%, mes 1997 dhe 2005”⁹. Pritet që ndikimi i europjanizmit të vendeve nga Europa juglindore të jetë edhe më i madh, duke e përfshirë këtu edhe Maqedoninë.

Proçesi i decentralizimit është kryesor për kuptim më të mirë të zhvillimit ekonomik maqedonas. prandaj grupi i QHKP vendosi të realizojë hulumtim në mikro nivel, duke marrë parasysh se dinamika ekonomike lokale e një komune është shembull i mirë për ekonominë në pjesë të ndryshme të vendit. Komuna për të cilën bëhet fjalë është **Gostivari**.

Hulumtimi ynë ishte kryer në periudhën prej prillit 2005 deri në qershor 2006 dhe përfshiu si analizë të detajuar studime të ndryshme, analiza, libra dhe analiza të të dhënave statistikore, si dhe intervista kualitative duke e shfrytëuar metodën e hulumtimit participator, marrë nga reth 130 pjesëmarrës-beznismenë, përfaqësues të administratës lokale, pronarë dhe

³ Karakterizohet me valutë stabile, vazhdimisht rimbajtje e likuidimit të jashtëm dhe të brendhëm të vendit dhe jashtëm zakonisht deficite të vogla të buxhetit qendror dhe shkallë të inflacionit prej 0,5% në vitin 2005.

⁴ 39,3% në vitin 2004 (sipas ILO definicioni)

⁵ Në vitin 2004 98,7% nga të gjitha firmat ekonomike aktive kanë patur më pak se 250 të punësuar që përfaqëson 61% gjithsej nga punësimi në vend.

⁶ Në vitin 2004 sipas hulumtimit në Entin për statistikë për dorën punuese, 52,4% nga të papunësuarit kanë mbaruar ja arsim fillor, ja më pak.

⁷ Derdhja per capita në vitin 2004 ishte 60, më e ultë se ajo nga Mali i Zi (80) dhe Shqipëria me 86 milion euro.

⁸ Kjo është lajmëruar në lajmërimin e KE për përmbajtje të kandidaturës së Maqedonisë për hyrje në UE (K (2005) 562...) “Republika e Maqedonisë ka institucione stabile, demokratike të cilat punojnë normalisht, i respektojnë kufijtë e kompetencave të tyre dhe bashkëpunojnë mes veti. Ekonomia ariti nivel të lartë në stabilitetin makroekonomik me inflacion të ulët, të balancuara financat publike dhe borxh i ulët public. Liberalizimi i çmimeve dhe tregëtisë është në masë të madhe i mbaruar. Sektori financiar është stabil. Dora punuese ka edukim themelor dhe infrastruktura e vendit (transport dhe telekomunikim) është mirë.”

⁹ Deklaratë e KE: “Zgjerim, dy vite më vonë: të gjithë fitojnë me pasurimin e vendeve antare të reja, 03/05/2006

të punësuar në kompani private, drejtorë dhe nëpunës, punëtori me gisa dhe qytetarë të rëndomtë.

Ne filluam këtë hulumtim duke u nisur nga pikëpamja se **Gostivari është në hapin e parë nga zhvillimi i tregut ekonomik**. Ka mungesë të kapitalit për investime dhe lehtësim të zhvillimit të mëtejshëm. Gostivari ka një nga shkallët më të ulta për aktivitetet në vend. Ajo ka ndikim direkt në shkallën e punësimit. Gostivarit i mungon fuqi punëtore e kualifikuar e cila do të ndihmonte aktivitetet ekonomike të komunës të ngrihen në nivel më të lartë cilësor, si nga sfera e prodhimtarisë ashtu dhe nga sfera e shërbimeve. Ka pak investime të huaja dhe ajo e pengon hyrjen e njohurive dhe teknologjive e reja.

Në këtë studim ne i hulumtojmë mundësitë që ekonomia në Gostivar të bëhet e kushtëzuar nga investime¹⁰. Vallë ekzistojnë potenciale që do ta stimulojnë zhvillimin ekonomik dhe cilat janë ato? Ne i caktuam “Kampionët” e ekonomisë në Gostivar. Me analizimin e tyre u munduam të zbulojmë cilët janë faktorët e nevojshëm që të krijohet mjedis për përcjelljen e sukseseve të tyre.

Aspekt tjetër kryesor i studimeve tona është politika publike dhe se si ajo ndihmon zhvillimin ekonomik. Analiza e gjendjes së tashme e krijimit të politikës në nivel lokal na mundëson ti përcaktojmë trendet, sukseset dhe nxitjet e vetëqeverisjes lokale si faktor kryesor politik për krijim të mjedisit të përshtatshëm për zhvillim ekonomik. Po ashtu e vlerësojmë edhe rolin e qytetarëve, biznes bashkësisë dhe pushtetit qendror.

¹⁰ Si çështë definuar në tabelën 1

Tabela 1: Nivele të zhvillimit ekonomik

Nivel i zhvillimit	Nxitje kryesore ekonomike	Fokusi i prodhimit	Arsim i nevojshëm dhe tregu i fuqisë punëtore
Zhvillim i kushtëzuar nga faktorë	Tregu duhet të funksionojë normalisht që të mund të mobilizohet toka, kapitali dhe fuqia e punës	Shfrytëzimi i burimeve natyrore, prodhimi bazuar në fuqinë e punës. Sektori primar është dominant.	Punësim veçanërisht në bujqësi, në industrinë për shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe në ndërmarjet e vogla. Arsimi i nevojshëm: arsim fillor, aftësi elementare, disiplinë e shprehive punuese
Zhvillim i kushtëzuar nga investime	Tërheqja direkte e investimeve të huaja dhe import i teknologjisë për shfrytëzimin e tokës, fuqia e punës dhe kapitali dhe lidhje fillestare e ekonomisë nacionale dhe globale	Prodhim dhe eksport i shërbimeve të deleguara. Sektori sekondar është dominant.	Rritja e punësimit në prodhimtari, shërbime dhe industrinë e mesme. Arsimi i nevojshëm; rritje e nevojshme e fuqisë punëtore me arsim të lartë dhe fakultet.
Zhvillim i kushtëzuar nga inovacionet	Shkallë e lartë e inovacionit dhe adaptimi e komercializimi i teknologjive të reja.	Prodhime dhe shërbime inovative në nivel të teknologjisë globale. Sektori terciar është dominant.	Punësimi kryesisht është në prodhimtarinë e lartë cilësore dhe sektori i shërbimeve dhe në firma me paisje të lartë teknologjike. Arsimi dhe njohuri të nevojshme: pothuaj arsim i lartë universal. Arsimi i lartë drejtues, teknik i modernizuar, mësim i vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive, treg fleksibil i fuqisë së punës (qarkullim i lehtë i fuqisë së punës), rritja e intersit për fakultete, veçanërisht për specializim në shkencë dhe inxhinieri, sektor dinamik për hulumtim dhe zhvillim që i lidh programet e larta arsimore me firmat inovatore.

Adaptuar nga QHKP nga *The Global Competitiveness Report, 2001/2001*, Klaus Schëab, Michael Porter, dhe Jeffrey Sachs, editors. The World Economic Forum, Gjenevë, 2001.

1

Gostivari-zhvillimi gjatë kohës së socializimit

Gostivari ndodhet në luginën e Pollogut, në 45 minuta udhëtim nga Shkupi. Toka është pjellore. Qyteti është rrethuar me male të larta, Shari, Bistra dhe Suva Gora. Lumi më i madh në Maqedoni, Vardari, buron në këtë territor. Gostivari ndodhet në rrugën ku do të kalojë Koridori 8, projektuar t'i lidh Varnën me Shkupin dhe Tiranën.

Gostivari për herë të parë përmendet në shekullin 14 nën emrin Sello Velika dhe në atë kohë ka qënë lagje e parëndësishme. Ashtu ka qënë deri në shekullin e 19 kur perjeton rritje masive dhe bëhet qendër rajonale për tregëti dhe zejтари¹¹. Bujqësia dhe kultivimi i kafshëve po ashtu ka kontribuar për ekonominë lokale. Numri i banorëve vazhdimisht rritej, prej rreth 2000 në vitin 1874 deri më 7832 në vitin 1948¹². Përbërja etnike në Gostivar ka qënë e lloj-llojshme. Maqedonasit dhe turqit kryesisht kanë qënë të koncentruar në qytet, derisa pjesa më e madhe e shqiptarëve ka jetuar përreth fshatrave malore¹³. Gjatë kohës së viteve të fundit në Perandorinë Osmane, Turqit masivisht shpërngulen në Stamboll dhe Anadoll¹⁴. Maqedonasit dhe shqiptarët e zunë vendin e tyre në qytet. Migracionet e këtilla vazhduan edhe gjatë kohës së periudhës mes luftrave. Shumë Shqiptarë u tërhoqën nga kultivimi i kafshëve dhe zbritën nga fshatrat

¹¹ Monografi për Gostivarin, Biblioteka Univerzitare Popullore, Shkup 1983, faqe 71-83

¹² Ibid

¹³ Janko Bilbiloski-“Gostivari dhe rajoni i Gostivarit”

¹⁴ Shih: http://ëëë.ozturkler.com/data_english/0008/0008_16_08_2.htm

malore, pjesë prej tyre që të mund ta shfrytëzojnë tokën pjellore të luginës së Pollogut, kurse pjesa tjetër u shpërngulën në qytet¹⁵.

Sot komuna Gostivar ka 35 lagje me gjithësej 81035 banorë, prej të cilëve 35847 jetojnë në qytet¹⁶. Komuna është një nga më të mëdhatë në Maqedoni. Shumicë e madhe e Maqedonasve, Romëve, Turqve jetojnë në qytet, ndërsa shqiptarët jetojnë si në qytet ashtu edhe në fshatrat përreth.

Tabela 2: Popullsia e përgjithëshme dhe përbërja etnike e komunës së Gostivarit pas Luftës së Dytë Botërore.

Përbërja etnike					
Viti i regjistrimit	Gjithësej	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë
1953	14928	4134	8213	1932	353
1961	18870	6641	7282	4473	... ¹⁷
1971	27214	9262	12539	4504	219
1981	39306	11429	20773	4426	1384
1991	20608	13594	... ¹⁸	4038	1977
1994	45740	13514	25186	4477	1884
2002	49545	13149	29236	4564	1904
2005	81035	15870	54038	7991	2237

Si shumë qytete të tjera në Maqedoninë socialiste, Gostivari përjetoj zhvillim intenziv industrial dhe urbanizim pas vitit 1945¹⁹. Prodhimi industrial në Gostivar kryesisht ka qenë e paramenduar për shfrytëzimin e burimeve natyrore të rajonit që është i përshtatshëm për bujqësi, zeytari, shfrytëzim i potencialit ujor dhe prodhime tekstile themelore me shfrytëzimin e pambukut dhe leshit të prodhuar në rajon.

¹⁵ Boge Dimitriiski "Ashtu flitët në Gostivar", Shkup 2000

¹⁶ Burim: Të dhëna nga regjistrimi në vitin 2002

¹⁷ Popullata e përgjithshme në komunën e Gostivarit u rrit vetëm nominalisht si rezultat i Ligjit të ri për ndarje territoriale i cili ishte miratuar në vitin 2004. Komunat më të vogla, Vrutoku, Banica e poshtme, çegrane, Srbinova ishin të përfshira në komunën e Gostivarit.

¹⁸ Popullata shqiptare e bojkotonte regjistrimin në vitin 1991

¹⁹ E vetmja prodhimtari industriale që ka qenë në Gostivar para luftës ishte fabrika për prodhimtari të tullave "Cigllana" themeluar në vitin 1936. Shih: "Stopanski vesnik, 23 shtator viti 1971, faqe.29

Duke marrë parasysh se para vitit 1945 në Gostivar nuk ka patur praktikisht asnjë aktivitet industrial, të gjithëa fabrikat kanë qënë të ndërtuara duke u nisur nga zeroja. Si edhe në rastin me shumë qytete maqedonase (si p.sh. Shtipi, Manastiri, Tetova, Kumanova) dhe Gostivari ishte bërë qendër e prodhimit tekstil në 1950.

Fabrika për prodhimin e tekstilit dhe veshjeve “Dekon” ishte ndërmarja e parë e madhe e hapur në Gostivar pas luftës. Ajo ishte themeluar në vitin 1948 nën emrin “Qilimarë”. Në fillim funksiononte si fabrikë për tapete, duke e shfrytëzuar lokalisht leshin e prodhuar dhe ishte e njohur për punimin me dorë të tapeteve siç bëhen ato persienet. Ndërmarja ishte transformuar në prodhues të veshjes dhe e ndroi emrin në “Proleter” në vitin 1973, ndërsa prej vitit 1982 punon nën emrin “Dekon”²⁰. Investimi i dytë në industrinë tekstile të Gostivarit ishte hapja e ndërmarjes për prodhime themelore të pëlhurave (stofeve) “Goteks” në vitin 1985. Themeluar si pëlhurendëse, ndërmarja në fillim ka prodhuar vetëm pambuk. Fabrika shpejt është zhvilluar dhe së shpejti filloi të prodhojë edhe fije sintetike nga fundi i vitit 1970, pastaj janë sjellë pëlkurat në vitin 1982, pasurimi i pëlhurave në vitin 1983 dhe prodhim të mbulesave në vitin 1985²¹.

Pjesa më e madhe e zhvillimit industrial pas luftës u koncentrua në shfrytëzimin e burimeve natyrore në afërsi të qytetit-burimet e ujit dhe të mineraleve të ndryshme si: dollomite, kalcium, karbonat, shkumës, mermer, argjil dhe rrërë. Rreth burimit të Vardarit në Vrutok dhe pjesa tjetër e rrethit të Gostivarit është e pasur me ujë, kështuqë, investimi në hidro-energji ishte hap logjik. Ndërtimi i hidrocentraleve që filloi në vitin 1947 ishte ndërmarja e parë serioze industriale në komunë. Hidrocentrali “Mavrovë” filloi me punë në vitin 1957 ndërsa u lëshua në punë nga Presidenti Tito²². Hidrocentrali “Mavrovë” u bë njëri nga prodhuesit kryesor

²⁰ Intervistë me Evica Miloshevska, udhëheqës i zyrës së “Dekonit”, 15 prill viti 2005

²¹ Shih: Stopanski vesnik 26 mars 1986

²² Shih: “Hidrocintalat e Gostivarit të revitalizuara”, Dnevnik 13 janar 2005

të energjisë elektrike në Maqedoni dhe u punësuan shumë banorë të Gostivarit.

Kapaciteti më i madh dhe kryesor industrial gjatë kohës së socializimit në Gostivar, fabrika për materiale zjarrdruuese “Sillika” ishte ndërtuar që t’i shfrytëzojë këto burime natyrore. Ajo ishte ndërtuar në vitin 1958 me vendim të Qeverisë të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Në fillim ndërmarja përbëhej vetëm prej “Allumo-Sillikat”, fabrikë për prodhimtari të materialeve silikone zjarrdruuese të cilët shfrytëzohen për prodhimin e stufave, qelqit dhe qymyr akumulatori. Së shpejti pas zbulimit të madh të sasisë dolomite në një fshat të afërt, u paraqit nevoja për hapje të fabrikës “Dollomit” për përpunim të dolomitit e cila ishte përfshirë në “Sillika” në vitin 1968²³. Një e treta e prodhimit të “Sillikës” ishte incestuar në tregun jugoslloven, ndërsa pjesa tjetër eksportohej në vendet e bllokut socialist si Romania dhe Çekoslovakia²⁴. Në vitin 1956 ishte hapur fabrika “Mermeri” për prodhimin e pllakave dhe mermerit dekorativ.

Bujqësia po ashtu ishte modernizuar pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1961 qenë instaluar tre fura të mëdha në “Zhito Shar”, fabrikë për përpunim e grurit dhe prodhues i miellit dhe bukës. Me këtë në Gostivar filloi prodhimi masiv e bukës. Ndërmarja u zgjerua në vitin 1976 me hapjen automate të furës dhe mullimit të ri²⁵. Reformimi i kultivimit të kafshëve ishte shkaku kryesor për hapjen e thertoresh industriale “Gorni Pollog” në vitin 1960. Në fillim ajo kryesisht procesionte mish dashi dhe qengji. Në vitin 1970 ajo filloi me eksport. Në vitin 1980 përveç veprimtarisë primare-procesuimi i kafshëve-fabrika filloi me prodhimin e suxhukut dhe mishit të konzervuar.²⁶

Modernizimi dhe zhvillimi i shpejtë i industrisë socialiste rezultonte me migrimin e Maqedonasve nëpër qytetet, zvogëllim drastik të popullatës

²³ Dollomiti është mineral që shfrytëzohet përmes tjerash edhe për prodhimtari të tullave zjarrdruuese apo si katalizator në industrinë për çelik.

²⁴ Intervistë me Jovançe Nikolovski drejtor i mëparshëm i “Sillikës”, 10 gusht 2005

²⁵ Intervistë me Borçe Jovanovski, drejtor i mëparshëm i “Zhito Shar”, 24 prill 2005

²⁶ Intervistë me Ruse Stefanovski, pronar dhe Zlatko Jakimovski, llogaritar kryesor i “Gorni Pollog”, 28 prill 2005

nëpër fshatra. Vetëm për tetë vjet prej vitit 1953 deri në vitin 1961 numri i Maqedonasve nëpër qytete u rrit për dy herë, kurse në vitin 1971 për tre herë²⁷. Rreth 36% e Maqedonasve kanë jetuar fshatrat rreth Gostivarit në vitin 1953. Deri në vitin 1971 vetëm 12% prej tyre jetonin në fshat. Përderisa Maqedonasit punësoheshin nëpër ndërmarjet socialiste të cilat më shumë zgjeroheshin, shumë Shqiptarë emigruan nëpër vendet e huaja, posaçërisht nëpër vendet e Europës Perëndimore si në Gjermani e cila i hapi dyert e veta për punëtorët nga Jugosllavia e Titos.

Tabela 2: Popullata e përgjithëshme dhe përbërja etnike në qytetin Gostivar pas Luftën së Dytë Botërore.

Viti i regjistrimit	Përbërja etnike				
	gjithësej	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë
1953	9509	2637	4313	1924	353
1961	12787	5092	2904 ²⁸	4349	...
1971	19467	8109	6044	4449	219
1981	27726	10127	10791	4378	1254
1991	18734	11946	...	4023	1842
1994	32926	12084	14128	4475	1609
2002	35847	11855	16890	4559	1899

Koha socialiste ishte kohë e ekspansionit dhe prosperitetit relative të komunës së Gostivarit. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, të punësuarit në ekonominë e Gostivarit jetonin jetë normale me kushte solide punësuese. Për shembull “Goteksi” kishte ambulancën e vet; restorant dhe qëndrim ditor për fëmijët e të punësuarve, kamp pushimi në liqenin e Ohrit dhe në Dubrovnik. Ndërmarja po ashtu bleu rreth 100 banesa për të punësuarit e

²⁷ Prej 2637 Maqedonë në qytet në vitin 1953 deri 5092 në vitin 1961 dhe 8109 në vitin 1971.

²⁸ Zvogëlimi i numrit të shqiptarëve në vitin 1961 qëndron në atë se shumë shqiptarë dhe pakica tjera muslimane deklaroheshin si turq me qëllim që t’i shfrytëzojnë beneficionet nga marrëveshja për emigrim mes Turqisë dhe Jugosllavisë prej 1950 që të mundin të emigrojnë në Turqi. Shih: Hju Polton, “Balkani. Shteti dhe pakicat në konflikt”, Londër, 1993, faqe 92.

vet²⁹. “Sillika” i përcillte punëtorët e vet nëpër banjo shëruese, duke patur në dispozicion ambulance, dentist dhe restorant³⁰. Fabrika kishte pushimoren e vet në Tivat (Mal të Zi) dhe Ohër dhe po ashtu u siguronte punëtorëve të vet edhe banesa³¹. Pos asaj që të punësuarit në “Sillika” dhe ndërmarjet e tjera socialiste kishin rroga solide, ekzistonte mundësia për marrje të kredive dhe huave të volitshme³². Rreth 300 familje nga Gostivari mundeshin të blejnë uikend shtëpi në liqenin e Mavrovës³³.

Të gjithë komponentat kryesore të industrisë socialiste në Gostivar ishin shfrytëzuar, punëtorë punësoheshin gati deri nga fundi i viteve 1980, periudhë kur shkalla e punësimit në ndërmarjet socialiste ishte më e madhe. Në këtë periudhë shtatë ndërmarjet e para nga Gostivari punësuan rreth 5350 punëtorë. Nga ana tjetër, në të shumtën e rasteve lloji i punës nga punëtorët nuk kërkonte ndonjë aftësi të veçantë. Rallë kush stimulohej për shkollim të mëtejshëm dhe përsosje.

Table 4: Numri i të punësuarve në ndërmarjet më të mëdha në Gostivar

Ndërmarje	Fundi i viteve 1980
“Sillika”	1900
“Goteks”	1300
“Mermeri”	700
“Vidoe Smilenski Bato”	500
“Dekon”	450
“Gorni Pollog”	300
“Zhito Shar”	200

²⁹ Ibid

³⁰ Shih: Stopanski vesnik, 1 dhjetor 1986, faqe 28

³¹ Intervistë me Jobançe Nikolovski, drejtor i mëparshëm i “Sillikës”, 10 gusht viti 2005

³² Intervistë me Lazar Lazarevski, punëtor i mëparshëm në “Sillika”, tani koordinator në zyrën e Gostivarit e Asociacionit të punëtorëve të lëshuar nga ndërmarjet e likuiduara në Maqedoni, 10 mars viti 2006

³³ Intervistë me Kiro Kiproviski, gazetar në Radio Gostivar, 3 mars viti 2006.

Edhe pse punësimi në Gostivar kishte rritje konstante, pjesa më e madhe e të punësuarve mbetën ose të trajnuar ose të arsimuar dobët³⁴. Niveli i tërësishëm i arsimit të popullatës së Gostivarit gjatë kohës së socializmit ishte i ulët. Në vitin 1951, shumica e popullsisë ishte e paarsimuar. Prej vitit në vit më shumë e më shumë banorë arsimoheshin, por edhe përkundër kësaj në vitin 1981 afër 13000 banorë ishin pa arsim formal, ndërsa 21500 banorë kishin kryer vetëm shkollën fillore. Vetëm 606 kishin diploma universiteti³⁵.

Edhe pse duket se sektori shoqëror ka lulëzuar gjatë kohës së viteve 1970 dhe 1980, komuna Gostivar bën pjesë në një nga 14 rajonet e pazhvilluara në Republikën Socialiste të Maqedonisë. Në realitet, zhvillimi i ndërmarjeve të Gostivarit nuk ishte ndërtuar mbi baza ekonomike. Për shembull, nga formimi i vet “Goteksi” asnjëherë nuk bëri fitim. Përkundrazi çdo vit vetëm shtoheshin borxhet. Fabrika shfrytëzonte teknologji të vjetëruar dhe i mungonte mekanizmi i nevojshëm³⁶. Përralla e “Dekonit” është e ngjajshme³⁷.

Pos ekonomive joadekuate të dy ndërmarjet ishin të përkrahura nga qeveria t’i zgjerojnë aktivitetet e veta dhe të hapin linja të reja të prodhimitarisë. Ato duhej t’i “apsorbojnë” gostivarasit e ri të papunësuar. Politikanët kanë patur të tillë ndikim mbi ekonominë, saqë në vitin 1986 në administratën e “Goteksit” e cila kishte problemet e veta, i ishte “këshilluar” ta marë fabrikën për tekstil “Skudrinje” e cila ka qënë në humbje³⁸. Ajo ka qënë praktikë e zakonshme e kohës e cila zbatohej edhe në ndërmarje të tjera. Si për shembull te “Sillika” e cila ndërmori ndërmarjen në humbje “IGM Vardar” nga Gostivari³⁹.

³⁴ Prej 1900 të punësuar në “Sillikë”, vetëm 198 kishin diploma univerzitare.

³⁵ Shih: Regjistrim prej vitit 1981, Enti për statistikë

³⁶ Intervistë me Dragica Nikolovska, zëvendës drejtor gjenerali i mëparshëm i “Goteksit”, 10 qershor viti 2005

³⁷ Shih: Stopanski vesnik, 4 qershor viti 1980

³⁸ Intervistë me Dragica Nikolovska, zëvendës drejtor gjenerali i mëparshëm i “Goteksit”, 10 qershor viti 2005

³⁹ “IGM Vardar” ishte trashëgimtar i fabrikës për tulla paralufte “Cigllana” e cila tani punon nën emrin “Tullana”.

Ndërmarrjet e ngarkuara me borxhe, me tepriçë kuadri të patrajnuar dhe shfrytëzimi i paisjeve të vjetëruara nuk mundën të vazhdojnë edhe gjatë⁴⁰. Shumë prej tyre nuk mundën edhe të paguajnë për lëndët e nevojshme. Fundi i përgjakur i Jugosllavisë dhe kolapsi i tregut të përbashkët vendas, ndërlikoi sërish punën e ndërmarrjeve në Gostivar. Shpenzimet për transport u zmadhuan, ndërsa rrugët drejt Europës nuk depërtonin lehtë. Tregëtia me blerësit perëndimor nuk ishte e lehtë dhe shumë mundësi për biznes u shkatëruan⁴¹. Më tej, me hapjen e ish vendeve komuniste në fillim të viteve 1990 u krijua konkurrencë për eksport në Europën Lindore, për arsye se kompanitë nga Europa Perëndimore filluan ta përvetësojnë atë treg.

⁴⁰ Prej 1900 të punësuarve në "Sillikën" vetëm 189 kishin diploma univerzitare

⁴¹ Në fillim të viteve 1990 me qëllim që të mbahen klientët "Sillika" ndërmori për gjegjësi për transportin e me atë i rriti borxhet dhe e zvogëloj fitimin.

2

Tranzicioni dhe gjendja e tashme -zhvillim i mikro sektorit

Në fillim të viteve 1990 Maqedonia përjetoi ndryshime të mëdha ekonomike dhe politike nga sistemi socialist në demokraci kapitaliste. Duke marrë parasysh se industritë udhëheqëse të mëparshme vazhduan të punojnë me humbje edhe në vitet 1990, numër i caktuar i të punësuarve duhej të pushohej nga puna. Grevat ishin dukuri e shpeshtë. Të gjithëa ndërmarjet e Gostivarit, përveç hidrocentralit “Mavrovë” i cili llogaritet se ka rëndësi strategjike për shtetin, u transformuan në shoqëri aksionere. Vijonin ndryshime të shpejta administrative, interesa të ndryshme dhe presione politike. Mirëpo, procesi i privatizimit nuk solli kapital të ri dhe menaxhim modern. Si rezultat i gjithëë kësaj, ndërmarjet e reja të privatizuara nuk patën sukses të bëjnë fitim. Gati gjithëë bankrotuan dhe u likuiduan.

Rasti me “Sillikën” është karakteristik. Në vitin 1995 ishte e vlerësuar në 30 milion marka gjermane (15 milion euro) dhe e ndarë në tre pjesë “AD Allumosillikati” - vlerësuar 4 milion euro me 500 të punësuar, “AD Dollomit” - vlerësuar 8 milion euro, me 130 të punësuar, dhe “AD Remont” - vlerësuar 250 mijë euro, me 70 të punësuar. “AD Allumosillikati” vazhdoi të punojë me humbje dhe falimentoi në vitin 2002⁴². Pasi u shpallën të pasukseshëm dy tenderat në vend, në tender ndërkombëtar ndërmarja iu shit ndërmarjes “Gemiks” nga Shkupi për 210000 euro në vitin 2003. Ndërmarja nuk vazhdoi

⁴² Shih: “Alumosillikati në falimentim”, Utrinski Vesnik, 22 fror viti 2002

me punë, me siguri pronari i ri kërkon partnerë të huaj të cilët do të investojnë në të.

Tabela 5: Numri i të punësuarve në ndërmarjet më të mëdha gjatë kohës së socializmit dhe sot⁴³

Ndërmarje	Fund i viteve 1980	Fund i vitit 2005
"SILLIKA"	1900	ca.140 ⁴⁴
"Goteks"	1300	ca. 40
"Mermeri"	700	E likuiduar
"Ohim-Ges" (ish fabrika Vidoe Smilenski Bato)	500	E likuiduar
"Dekon"	450	350
"Gorni Pollog"	300	ca. 50
"Zhito Shar" (ndërmarje për përpunim të mjellit dhe prodhim të bukës)	200	130
"Getro" (tregëti me shumici dhe me pakicë, ish tregëtia e Gostivarit)	450	ca.200

Pjesa më profitabile nga "Silika" e dikurshme, "AD Dollomit" kaloi më mirë. Ishte shitur për 750 mijë euro kompanisë turke "Haznedar", njëra nga kompanitë më të mëdha për prodhim të materialeve zjarrduruese në Europë. Në procesin e bisedimeve Qeveria e detyroi investitorin e ardhshëm të punësojë 83 persona, të investojë 4 milion euro në pesë vitet e ardhshme dhe të realizojë prodhim vjetore prej 45000 tonelata material zjarrdurues⁴⁵. Ndërmarja u kryqëzua në "AD Vardar Dollomit" dhe ka 72 të punësuar. Deri tani pronari i ri ka investuar më tepër se pesë milion euro.

Miniera në Çajle, e cila më parë ishte pjesë nga "Sillika", në vitin 2001, iu dha nën koncesion nëbiznismentit Ekri Elmazi për 1500000 marka gjermane

⁴³ Numrat në tabelë janë kombinim i të dhënave të mara nga regjistri Qendror dhe vlerësim nga QHKP bazuar në intervistat e realizuara dhe situatë faktike.

⁴⁴ Numri i përgjithshëm i të punësuarve nëpr ndërmarjet si rezultat i transformimeve të "Sillikës" së dikutshme.

⁴⁵ Intervistë me Dragan Filipovski, besimtar i mëparshëm i "Alumosillikat", "Dollomit", "Remont" dhe "Mermeri", 8 prill viti 2005

(75000 euro)⁴⁶. Por, në minierë punohet shumë pak, numri i të punësuarve rra prej 75 në fundin e viteve 1990 deri në 30; pronari sikur kujdeset më tepër për dy ndërmarjet që janë në pronësi të tij sesa për minierinë⁴⁷. Fabrika për tulla "Tullana" po ashtu njëri nga trashëgimtarët e "Sillikës" ka një pamje brengosëse. Mund të shihet "peizash apokaliptik" me ndërtesa të rrënuara, dritare të thyera, dyer të vjedhura, lokale të zbrazëta dhe të lëshuara pa njerëz përveç rojeve në hyrje.

Edhe ndërmarja e dytë më e madhe industriale në Gostivar "Goteksi" kaloi rrugën me ferra të tranzicionit. Vitet 1990 ishin periudhë e dështimeve. Në vitin 2001 "Goteksi" ndaloi me prodhim, u shpallur ndërmarje që punon me humbje dhe vitin e ardhshëm falimentoi. Në fillim të vitit 2004 "Eskima Komerc" nga Shkupi e bleu ndërmarjen për 62000 euro⁴⁸. Pronari i ri filloi me prodhim në fund të qershorit 2004⁴⁹. Fabrika për prodhim të pllakave dekorative dhe mermer "Mermeri" nuk kaloi më mirë. Ishte shitur për 305000 euro në tenderin në vend, e më pas u rishit edhe dy herë të tjera, sepse nuk fillonte të prodhojë⁵⁰.

Prodhuesi i veshjeve "Dekon" është ndërmarja e vetme që e përjetoi periudhën e tranzicionit. Tani ka 350 të punësuar dhe është punëdhënësi më i madh në komunën e Gostivarit⁵¹. Mirëpo "Dekoni" punon dhe prodhon sipas porosive me vlerë të vogël dhe ajo s'ka të ardhme të ndritur. Të punësuarit janë gjysëm të trajnuar, gra të cilat vetëm qepin dhe rrogat e tyre janë të ulta. Deri tani "Dekoni" mbahet në treg fal fuqisë së lirë të punës dhe afërsive së tregut përfundimtar, mirëpo ajo nuk garanton stabilitet

⁴⁶ Intervistë me Dragan Filipovski, besimtar i mëparshëm i "Alumosillikat", "Dollomit", "Remont" dhe "Mermeri", 8 prill viti 2005. Intervistë me Ekri Elmazi, koncesioner i minierës në "çajle", 13 qershor viti 2005.

⁴⁷ Intervistë me Zdravko Trpevski, drejtor i mëparshëm i minierës "çajle" dhe anëtar i mëparshëm i administratës "Allumosillikata". 23 mars viti 2006. Intervistë me Ekri Elmazi, koncesioner i minierës në "çajle", 13 qershor viti 2005

⁴⁸ Sipas Dragica Nikolovska, zavadës general drejtori i mëparshëm i "Goteksit", ndërmarja ishte vlerësuar në 15 milion marka gjermane në fillim të viteve 1990.

⁴⁹ Shih: Endëtorja e "Goteksit" në lëvizje, Dnevnik 3 gusht viti 2004

⁵⁰ Intervistë me Ivan Markovski, i punësuar i mëparshëm në "Mermeri", tani menaxher në kompaninë për përpunimin të mermerit "Heming Inzhinering" e cila jep me qira pjesë nga lokalet e "Mermerit", 8 qershor viti 2005.

⁵¹ Të dhëna nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë

afatgjatë në industrinë dinamike për veshje në botë me konkurrencën e rritur nga Kina dhe vendet e tjera të Europës Juglindore. E ngjajshme është situata edhe me firmat e tjera prodhuese nga Gostivari.

Grafiku 1: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Aktivitete me vlerë të dhënë të vogël

- a) Sektoret ekonomike të cilat mbisundojnë në Gostivar si karakteristikë të vet kryesore i kanë aktivitetet me vlerë të dhënë të vogël
 - i) Firmat tekstile për qepje, prodhim sipas porosisë (Dekon)
 - ii) Firmat për përpunimin e drurit vetëm konstruktojnë dyer, korniza, dritare dhe roleta nga materialet importi dhe të gjatshme. (Allfa Les)
 - iii) Firmat e mbyllin prodhimin e vet, restruktohen dhe koncentrohen vetëm në tregëti me prodhime të cilat i kanë prodhuar më parë (Frigo Vaar)

Grafiku 2: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Nivel i ulët i investimeve të huaja direkte

- b) Në periudhën mes vitit 1991 dhe 2004 komuna e re Gostivar pati sukses të tërheqë vetëm 6 milion euro investime të huaja. Kjo përbën përqindjen të pakonsiderueshme prej 0,5% nga investimet e përgjithëshme të huaja në Maqedoni, të cilat janë po ashtu të pakonsiderueshme dhe vlerësohen në 1,3 miliard euro për periudhën e lartpërmendur.
- c) Shkaku për nivelin e ultë të investimeve të huaja në komunë është mes të tjerash edhe ekzistimi i paragjyqimeve se rajoni i Pollogut, duke përfshirë edhe Gostivarin është rajon me rezik të madh politik dhe sigurie.
 - I. Shumica nga organizatat ndërkombëtare dhe agjensitë edhe më tej kërkojnë leje për qëndrim për shkaqe sigurie, para se personeli i tyre të qëndrojë në rajonin Tetovë-Gostivar (UNDP, Banka Botërore, MMF)
 - II. Bankat nuk dëshirojnë t'i përkrahin investimet e firmave lokale për shkak të rrezikut të madh. (Sezllinger)

Gjatë kohës së transformimit numri i përgjithëshëm i të punësuarve në 8-të ndërmarjet, shtyllat e dikurshme të industrisë së Gostivarit, u zvogëlua prej 5800 nga fundi i 1980 deri reth 910 në gjysmën e parë të vitit 2006. Ishin

bërë vetëm dy investime të huaja direkte në sasi prej 6 milion euarosh, që është më pak se 1% nga investimet e përgjithëshme në Maqedoni⁵².

Rritja graduale e papunësisë ishte rezultati më konkret nga transformimi i ekonomisë në Gostivar. Kolapsi i ndërmarrjeve socialiste në Gostivar rezultonte me humbje mbi 4900 vende pune. Edhe pse industritë e mëdha në Gostivar nuk pushuan të ekzistojnë gjatë natës, megjithëatë shkatërimi i tyre ishte një nga shenjat më dramatike të tranzicionit

Tabela 6: Rritja e papunësisë në komunën Gostivar, pas fillimit të periudhës së tranzicionit⁵³

Viti	Numri i regjistruar i personave të papunë në Gostivar
1992	6975
1993	7273
1994	8212
1995	9375
1996	10552
1997	9707
1998	10671
1999	11832
2000	12321
2001	13417
2002	15397
2003	16373
2004	16764
2005	16773
2006 ⁵⁴	16083

⁵² Shih: Për shembull, Banka Europiane për rekonstruim dhe zhvillim, RAPORT PËR TRANZICIONIN, maj 2006 faqe 45.

⁵³ Të dhëna nga Novak Ristovski, hulumtues i tregut për dorë punuese nga Enti për punësim në Gostivar.

⁵⁴ Numri i të papunësuarve në Gostivar përfundimisht me 31 janar viti 2005

Në fillim të janarit 2006, 16083 veta ishin regjistruar në Entin për punësim në Gostivar. Më tutje, kishte më tepër prej 7000 shfrytëzues të pensioneve të ndyshme (pleqërie, invalide, pensione familjare). Nga regjistrimet zyrtare, persona të papunësuar, 5541 (prej të cilëve 400 janë me diploma univerzitare), ishin më të rinj se 30 vjet të cilët nuk punonin më tepër se 5 vjet⁵⁵. Enti supozon se rreth 7000 veta të cilët janë regjistruar si të papunësuar, në realitet edhe nuk kërkojnë punë, por e shfrytëzojnë statusin e të papunësuarve për fitim të sigurimit shëndetësor⁵⁶.

Grafiku 3: Indikatorë për gjendjen në komunën e Gostivarit

Shkallë e lartë e papunësisë

- d) Ka 16083 të papunësuar në komunën Gostivar (Njësia rajonale e Entit për punësim, janar viti 2006)
- e) Aktiviteti ekonomik/shkalla e punësimit në Gostivar është 21,3%, që është një nga më të ultat në vend. (Enti për statistikë)
- f) Hapen vende të reja pune, por jo më tepër se 100 në muaj. Shumica prej tyre janë sezonale (Njësia teritoriale e Entit për punësim)

Sot, shumë pak njerëz punojnë në Gostivar. Numri zyrtar i vendeve punës të regjistruara është gati gjysëm në krahasim me fillimin e 1990. Zyrtarisht të punësuar në Gostivar ka shumë pak, vetëm 10087 persona⁵⁷. Po të meret parasysh se ka 51063 banorë në moshë mes 15 dhe 64 vjet, atëherë fitojmë pamjen e vërtetë për shkallën e aktivitetit (rreth 21,3%) që është një nga më të ultat në gjithë vendin. Por, nuk duhet ta harojmë ekonominë e zezë që siguron numër të rëndësishëm vende pune në Gostivar.

⁵⁵ Ibid

⁵⁶ Shih: "Në Gostivar reth 7000 persona fiktiv kërkojnë punë", Utrinski Vesnik, 26 dhjetor viti 2005

⁵⁷ Burim: Enti për statistikë, regjistrim viti 2002, Libri 6-"popullata në vendin sipas aktivitetit", Shkup, prill viti 2004, faqe 30, 31, 33, 55, 59.

Tabela 7: Numri i përgjithshëm i të papunësuarve zyrtarisht në teritoret e urbanizuara dhe rurale dhe ndarje sipas gjinisë

Numri i përgjithshëm i të papunësuarve (janar vitit 2006) ⁵⁸	Qyteti Gostivar	Teritore rurale	Burra	Gra
16083	8649	7434	11046	5037
Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Të tjerë
3681	9274	1340	663	1100

Shumë nga të punësuarit punojnë në sektorin publik, në administratën komunale, në shëndetësi apo në institucionet sociale, kulturore, arsimore, juridike. Në realitet, punëdhënësi më i madh në komunën e Gostivarit është spitali i cili ka 650 të punësuar, më pas vijon HC “Mavrovë” me 360⁵⁹. Në sektorët e ndryshëm të administratës komunale punojnë rreth 100 persona, ndërsa ndërmarja komunale “Komunalleci” ka 200 të punësuar⁶⁰.

Tabela 8: Punëdhënësit më të mëdhenjë në komunën Gostivar (fillimi i vitit 2006)

Punëdhënësi	Numri i të punësuarve	Lloji i ndërmarjes
Qendra medicinale	650	Publike
HC “Mavrovë”	360	Publike
“Dekon”	350	Private
“Getro” ⁶¹	200	Private
“Komunalleci”	200	Publike
“Elektrodistribucioni” ⁶²	136	Publike
“Zhito Shar”	130	Publike

⁵⁸ Të dhëna nga Novak Ristovski, hulumtues i tregut për dorë punuese nga Enti për punësim në Gostivar.

⁵⁹ Shih: Intervistë me Zhare Trpevski, drejtor i HC “Mavrovë”, 31 mars viti 2006.

⁶⁰ Shih: Intervistë me Hasip Jusufin, drejtor në “Komunaleci”, 17 fror viti 2006.

⁶¹ Sipas të dhënave të Regjistrimit Qendror “Getro” ka 110 të punësuar, kurse në faqen zyrtare të internetit të kompanisë (www.getro.com.mk) mund ta shohim numrin prej më tepër se 300 të punësuar. Vlerësimi unë është se 200 është më afër situatës faktike.

⁶² Ndërmarje që merret me distribuimin e fuqisë elektrike

Duke patur parasysh nivelin e ulët të arsimit në Gostivar, nuk është habi që aq pak njerëz janë të punësuar. Medis tyre që janë regjistruar si të papunësuar, vetëm pjesë e vogël kanë diploma univerzitare (2%)⁶³. Rreth 21% prej tyre që kërkojnë punë kanë mbaruar shkollë të mesme, kurse 77% të tjerë në raste më të mira kanë mbaruar shkollën fillore.

Grafiku 4: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Hap i ulët i arsimit	
g)	80,6% nga popullata e aftë për punë në komunën Gostivar ka mbaruar vetëm shkollë fillore (Enti për Statistikë)
h)	75,69% nga të papunësuarit në komunën Gostivar, kanë mbaruar vetëm shkollë fillore (njësia territoriale e entit për punësim)
i)	Nuk ekzistojnë të dhëna për të punësuarit sipas nivelit të tyre të arsimit
j)	Ekziston nevojë për kuadër të arsimuar
i)	Vërehet mungesa e gazetarëve dhe redaktorëve. Disa media e zgjedhin këtë problem me "import" të kuadrit të nevojshëm nga qytetet tjera në Maqedoni, më së shpësti nga Tetova (Monitor)
ii)	Ekziston edhe nevojë për punëtorë të stërvitur në sferën e përpunimit të mermerit. Firmat pa tjetër duhet të marrin punëtorë nga vende tjera, Kriva Palanka (Heming)

Sektori privat është dominant në Gostivar. Ka numër të madh ndërmarjesh në sektorin privat. Gjithësej 6131 subjekte të ndryshme janë regjistruar në komunë në fund të nëntorit të vitit 2005⁶⁴. Por, Dragan Zafirovski, udhëheqës kryesor në Entin për sigurim shëndetësor në Gostivar, llogarit se 2200 prej tyre kanë qënë aktiv, d.m.th. kanë paguar tatime dhe ndihmë sociale për të punësuarit e vet⁶⁵. Nga ana tjetër, Regjistri qendror për subjektet afariste në Maqedoni vlerëson se numri i kompanive aktive në komunën Gostivar është 1300. Ndërmarjet e vogla dhe të mesme përbëjnë më shumë se 99% nga subjektet afariste në Gostivar. Ka vetëm shtatë


⁶³ Ibid

⁶⁴ Shih: Enti për statistikë, lajmërim afatshkurtë "Subjekte afariste në Republikën e Maqedonisë-gjendja 30 nëntor viti 2005", 8 dhjetor viti 2005 Shkup.

⁶⁵ Intervestë me Dragan Zafirovski, udhëheqës kryesor në Entin për sigurim shëndetësor në Gostivar, 8 prill viti 2005.

kompani me më shumë se 100 të punësuar. Numri i kompanive që punësojnë më shumë se 10 punëtorë është po ashtu shumë i vogël, jo më i madh se 40-50⁶⁶. Ata që mbisundojnë janë pronarë të vetëm apo kompani që tregëtojnë me pakicë dhe firma që ofrojnë shërbime me 2-4 të punësuar, duke përfshirë pronarin edhe menaxherin.

Grafiku 5: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar



Sektori i ndërtimit dhe aktivitetet e ngjajshme si prodhimi dhe tregëtia me mobilje, dritare, dyer, dysheme, paisje për banja si dhe përpunimi i materialeve të ndryshme (mermer, çimento, granit) është pjesa më aktive e ekonomisë. Shkaku kryesor për këtë është kërkesa e madhe nga ana e emigrantëve të Gostivarit. Gasterbajterët të ashtu qajtur në popull investojnë pjesë nga mjetet e tyre të fituara jashtë shtetit në ndërtim të shtëpive apo blerje të banesave në vendlindjen e tyre. Zyrtarisht, sipas të

⁶⁶ Kombinim të dhënash fituar nga Regjistri qendror dhe vlerësim i QHKP bazuar në intervistat e mara dhe situatë në praktikë.

dhënave statistikore, 295 objekte private me sipërfaqe mesatare prej 69 metër katëror dhe çmim mesatar prej 31000 euro ishin ndërtuar në komunën e Gostivarit në vitin 2004⁶⁷. Vetëm Shkupi dhe Tetova kanë ndërtuar më shumë objekte për një vit. Ndërtimi dhe sektorët e ngjajshëm janë fuqia lëvizëse e ekonomisë së Gostivarit në vitet e fundit. Firmat më aktive në sektorin e ndërtimit si “Leart Proekt” dhe “Terapllan” ndërtojnë 40-50 objekte në vit. Thjesht, ndërtojnë shtëpi pa dizajn për enterierin që i është lënë pronarit. Shtëpia mesatare koshton 30-40 mijë euro⁶⁸. Edhe pse ky trend sikur bie viteve të fundit, shumica e emigrantëve ndërtojnë shtëpi private dhe nuk blejnë apartamente⁶⁹. Nëse ndonjëri dëshiron të blejë tokë që është e caktuar për ndërtim të shtëpisë apo ndërtese në qendrën e Gostivarit, atëherë do të duhet të paguajë mes 1000 dhe 1500 euro për metër katror.

Shtëpitë e vjetra në qendër shiten mbi 300 mijë euro⁷⁰. Në realitet, emigrantët dhe dëshira e tyre për investim të “sigurtë” në pasuri të paluajtshme janë fajtorët kryesor për çmimet aq të larta të tokës në Gostivar.

Kompanitë si “Leart Proekt” dhe “Terapllan” kanë nga rreth 30 punëtorë, një pjesë e tyre janë punëtor sezonal. Rroga mesatare mujore është 200-250 euro. Lokalet e punës të kompanive përbëhen prej zyrës në qytet dhe depo në periferi të qytetit. Sipas Lirim Tarvarit, drejtor i “Leart Proekt” ka rreth 15 kompani të cilët legalisht punojnë në sektorin e ndërtimit⁷¹. Përveç këtyre kompanive ka edhe numër të parëndësishëm që ndërtojnë pa lejet dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe pa paguar tatimet. Përveç konkurrencës jolojale, kompanitë si “Terapllan” ballafaqohen edhe me probleme gjatë arkëtimit dhe borxheve të mëdha për punën e mbaruar⁷².

⁶⁷ Enti për statistikë, Raport për “Ndërtimet të përfunduara dhe objekte banesore ndërtuar nga persona privat në vitin 2004”, 7 qershor viti 2005.

⁶⁸ Intervistë me Lirim Travarin, 8 qershor viti 2005 dhe 24 fror viti 2006.

⁶⁹ Intervistë me Rafet Jakupin, drejtor i ndërmarrjes shoqërore publike “Gostivar”, 24 fror viti 2006.

⁷⁰ Shih: “Shtëpi të vjetra shiten për million euro”, Utrinski Vesnik, 13 gusht viti 2005.

⁷¹ Intervistë me Lirim Travarin, 8 qershor viti 2005 dhe 24 fror viti 2006.

⁷² Intervistë me Gazmendin, economist kryesor në “Terapllan”, 17 gusht viti 2005.

Grafiku 6: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve

- n) Shumica e biznesëve në Gostivar kanë probleme gjatë arkëtimit, si nga partnerët privat, ashtu edhe nga shteti. (Terapllan, Euro-Granit, Saxhem, Uniterm, Jefuta)
- o) Kjo i detyroi kompanitë të:
 - i) Të insistojnë në pagesë të gatshme dhe përpara (Leart)
 - ii) Punojnë me kompensime (Saxem)
 - iii) T'i afatizojnë mjetet për mbulim të borxheve (Euro-Granit)
- p) Në çdo rast, problemi me arkëtimin e borxheve dhe mënyrat e tashme për sharkimin e tij e pengojnë realizimin e zhvillimit në komunë.

Mund të gjenden shumë shërbime në sektorin e ndërtimit në Gostivar. Që të fillohet me ndërtim shtëpie apo banese, të nevojshme janë materiale si çimento, beton, granit, mermer etj. Në Gostivar ato sigurohen nga kompanitë siç janë: fabrika për tulla "Tullana", fabrikat për përpunimin e mermerit "Heming Inzhenering" dhe "Korab Mermer" apo fabrika për përpunim të granitit "Euro-Granit". "Tullana" është kompani e vetme që shfrytëzon materiale shtëpiake; konkurentët e tjerë që importojnë materiale ankohen nga doganierët e koruptuar, si dhe nga niveli i lartë dhe joreal i taksave doganore⁷³.

Kur shtëpia do të ndërtohet, sendet kryesore si parket, dysheme, dyer dhe dritare sigurohen prej firmave si "Kverkus", "Kome Kompani", "Euro-bodeni", "Zuli Mebel apo "Sezlinger". Shumë prej këtyre firmave po ashtu kanë linjat e tyre për prodhim dhe lidhje. Pra, përveç zyrës dhe depos kanë edhe fabrika të vogla. Punësimi nëpër këto fabrika është relativisht i vogël

⁷³ Intervistë me Ivan Markovski, pronar i "Heming Inzhenering", dhe Natasha Gegovska, llogaritar në "Korab Mermer", 8 qershor viti 2005.

dhe kryesisht sezonal, numri mesatar i të punësuarve nuk e tejkalon numrin 20. Pjesën më të madhe të prodhimit të tyre firmat e shesin në nivel lokal, kurse eksporti është ose shumë i vogël dhe i kufizuar në vendet fqinje, ose nuk ekziston fare.

Grafiku 7: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Dalje e dobët në tregjet e huaja

- q) Vetëm pjesë e vogël e kompanive eksportojnë pjesë më kryesore nga prodhimet e tyre.
 - (1) Vardar-Dolomit (materiale zjarrduruese)-99,5%
 - (2) Gorni Pollog (mish qengji) - 80%
 - (3) Saxhem (bojë dhe llaqe)- 50%
 - (4) Gudallat (lëngje frutash)- 50%
 - (5) Fatina (mobilje)- 50%
 - (6) Special (regullime për ngrohje dhe ftohje)- 40%
- r) Shumica e kompanive ose nuk eksportojnë, ose eksportojnë shumë pak
 - i) Sezllinger (mobilje)- 0%
 - ii) Euro-Granit (granit i përpunuar) - 0%
 - iii) Kamin (kaminë) - 0%
 - iv) Kome Kompani (RVS dyer dhe dritare) - 10%
- s) Ekzistojnë kompani të cilat duan të eksportojnë, por nuk mund t'i plotësojnë kushtet për eksport, ose janë në proces të fitimit të lejeve të nevojshme.
 - i) Fejzi (djath)-është shembull për të fundit
- t) Nuk ekzistojnë të dhëna për eksportin e firmave sipas komunave
- u) Eksporti kryesisht është koncentruar në vendet fqinje.
- v) Shkaqe të mundshme për dalje të këitillë të dobët në tregjet e huaja, mund të jenë prodhimet jokonkurrense, mungesa e njohurive për atë se si funksionojnë tregjet e huaja, barrierat tregëtare, apo proteksionizmi i fshehur.

Grafiku 8: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Konkurrencë jolojale

- w) Qëndrimi i përgjithëshëm i kompanive lokale është se konkurrenca jolojale në Gostivar është prezente. Sipas burimeve lokale, sektor më të rrezikuar janë ndërtimi, transporti, shërbimet dhe bujqësia.
 - i) Në Gostivar ekzistojnë rreth 15 firma legale në sektorin e ndërtimit. Të tjerët punojnë pa lejet e nevojshme dhe nuk paguajnë tatime. Firmat e tilla jolegale i kryejnë punët me çmime shumë të ulta, që i ulin çmimet në nivel joreal ekonomik. (Leart, Terapllan. Cikllama, Florida Sali)
 - ii) Konkurrenca jolojale është poashtu shumë e pranishme edhe në transport. Ekzistojnë shumë transportues të paregjistruar në Gostivar. Ata nuk paguajnë tatime dhe ajo ua zvogëlon shpenzimet. Me shpenzime të ulta transportuesit e paregjistruar janë në mundësi të ofrojnë çmime të ulta joreale të cilat u japin përparësi tregut. (Habib Turs)
 - iii) Konkurrenca jolojale është njëra nga pyetjet më kryesore edhe në hotelieri dhe turizëm, sepse shumë firma nga ky sektor funksionojnë jashtë sistemit tatimor. (Kalesh Angja)
 - iv) Konkurrenca jolojale ekziston edhe në bujqësi, prej mungesës së rregullt të inspektimit veterinar dhe kontrollit (Gorni Pollog)
 - v) Po ashtu ekziston konkurrencë jolojale edhe në sektorin e tregëtisë me pakicë dhe me shumicë. (Gimi Kompani)

Pas vendosjes së dyshemesë së re, dyerve dhe dritareve, hap i mëtejshëm është blerja e mobiljeve. Këtu kryesorja është "Fatina", prodhuesi i parë privat i mobiljeve në Maqedoni, themeluar në vitin 1990⁷⁴. Në fillim kishte pesë punëtorë dhe zgjidhje modeste të prodhimeve, kurse sot ka 60 të punësuar (me çfarë është punëdhënësi më i madh në sektorin e ndërtimit dhe sektoret e tjerë të ngjajshëm), ofron lloje të ndryshme të sofave dhe mobilje të tjera. "Fatina" eksporton pjesë të rëndësishme nga prodhimet e veta nëpër vendet siç janë: Shqipëria, Sllovenia, Kosova, Çekia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Ukraina dhe Moldavia, dhe më pak varet nga vullneti i mirë i emigrantëve që shpenzojnë të holla në Gostivar. "Fatina" është një nga shembujt e rrallë të kompanisë së suksesshme në

⁷⁴ Intervistë me Kenan Zhupanin, themelues dhe menaxher general i "Fatina", 15 prill viti 2005.

Gostivar dhe rezultatet e saj janë të njohura edhe jashtë komunës. Për punën e suksesshme në vitin 2004 kompania fitoi shpërblim të veçantë nga Oda ekonomike e Maqedonisë për katër vite të njëpasnjëshme.⁷⁵ E ngjashme, e “Leart Proekt” dhe “Terapllan”, menaxheri i “Fatina” Kenan Zhupani e llogarit konkurrencën jolojale për pengesë shumë serioze për udhëheqje të biznesit të suksesshëm në komunën Gostivar.

Që të mbarohet paisja e shtëpisë apo banesës, duhet të vizitohet rruga Beliçica, “kopsht parajse për mobilje dhe orendi”. Kjo rrugë e cila gjendet afër qendrës së qytetit ka 56 dyqane të pabesueshme. (prej gjithësej 65 dyqaneve që ndohen në rrugë) të cilat tregëtojnë me: mobilje, roletna, dyer, dritare, pllaka qeramike, fasada, paisje sanitare, aparate amviserie etj. Shumica prej këtyre shitoreve shesin prodhime importi me pakicë dhe kanë jo më tepër se 3-4 të punësuar. Por, koncentrimi i këtillë në një vend i dyqaneve që punojnë me mobilje dhe orendi është i vetmi në Maqedoni.

Grafiku 9: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Pengesa për hyrje deri te tregjet komunale fqinje

- x) Disa kompani lokale ankohen se konkurentet e tyre prej vendeve të tjera (veçanërisht nga Tetova) fitojnë tendere në Gostivar, ndërsa kompanitë nga Gostivari asnjëherë, ose shumë rrallë fitojnë tenderë në vende të tjera (veçanërisht në Tetovë) (Jefuta, Çede Siljanovski-Ministria për transport dhe lidhje)
- y) Disa kompani janë orvatur të depërtojnë në tregun e Tetovës, por pa sukses (Euro-Granit)
- z) Qëndrimi i përgjithëshëm mes biznesmeneve lokale është se kompanitë kanë mundime për të hyrë në tregun e Tetovës, vetëm pse janë nga Gostivari. Ato dyshojnë se në Tetovë i mbrojnë bizneset e veta me mjete jolegale. (Terapllan, Vitamin Aga, Albesa)

⁷⁵ Shih: “Të shpërndara shpërblimet vjetore të dhomës ekonomike”, Utrinski Vesnik 19 from viti 2004.

Ndërtimi kryesisht varet nga kërkesa e gastërbajterëve gostivaras kurse ajo nuk garanton punësim stabil dhe në të shumtën e rasteve ofron punë sezonale. Natyra sezonale dhe numrit më të madh të punësuarve në tregun e Gostivarit vetëm e kishte nxitur emigrimin e mëtejshëm në rast të zvogëllimit të kërkesës për shtëpi të reja dhe banesa. Numri më i madh i bashkëbiseduesve të cilët QHKP i intervistonte nga sektori i ndërtimit, pranojnë se biznesi nuk lulëzon më si përpara disa viteve. Stojmir Damjanovski, menaxher i “Cikllanës”, një nga firmat e ralla të ndërtimit në tregun maqedonas, thotë se ndërtohen më pak objekte të reja dhe se “gastërbajterët nuk ndërtojnë aq shumë si më parë”.⁷⁶ Më shumë se 90% nga të intervistuarit nga sektori i ndërtimit e ndajnë qëndrimin me Stojmirin.

Grafiku 10: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Kapacitet i dobët i investimit në bizneset lokale

- aa) Kompanitë planifikojnë blerje të paisjeve të reja, por i mungojnë mjetet adekuate financiare, kurse huatë nga bankat kanë kamata të larta.(Gogo Gradba).
- bb) Kjo është pengesë për përdorimin e teknologjive të reja, që është parakusht për zhvillim të secilës kompani dhe ekonomisë në përgjithësi.

Edhe pas asaj, pak menaxherë kanë plan rezervë. Sami Muxhaiti, themelues dhe menaxher i “Saxhem Hromos”, njëra nga kompanitë udhëheqëse në sektorin e ndërtimit, është i vetëdijshëm për rrezikun nga muarësia prej gastërbajterëve.⁷⁷ Edhe pse “Saxhem Hromos” është shumë e siksesshme në prodhimin dhe tregëtia me bojë dhe llaqe, bashkëpunon edhe me 160 dyqane nëpër tërë Maqedoninë dhe eksporton 50% nga prodhimet e veta. Samiu e di gjithëmonë duhet të shkohet përpara që të jesh i siksesshëm.

⁷⁶ Intervistë me Stojmir Damjanovski, menaxher i “Cikllanës”, 17 mars viti 2006.

⁷⁷ Intervistë me Sami Muxhaitin, 12 gusht viti 2006 dhe 17 mars viti 2006.

Para pak kohësh ai hapi linjë të re prodhuese. Por ai edhe do të fillojë me beznis të ri, prodhim të frutave dhe perimeve të thata dhe prodhim të keçapit dhe C Vitaminë. Për fat të keq sot ndërmarrësit si Samiu janë më tepër përjashtim, sesa rregull në Gostivar.

Grafiku 11: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Njohuri të dobëta për biznesin dhe aftësi për marketing

- cc) Ka disa kompani që do të kishin dashur t'i zgjerojnë aktivitetet e veta, por u mungon njohuria e nevojshme si ta bëjnë atë. (Gorni Pollog)
- dd) Disa kompani investojnë në zhvillim të tokës, pa ndonjë ide të qartë për atë. (Jefuta)
- ee) Bankat rrefuzojnë t'i përmbajnë projektet e firmave, për shkak, mes të tjerave, të elaborimit të tyre të përmjaftueshëm (Sezllinger)
- ff) Fabrikat janë të detyruara të pëshojnë punëtorë dhe ta zvogëljojnë prodhimtarinë, por, për shkak të paaftësisë së tyre të arrijnë deri te numri i mjaftueshëm i shpenzuesve (Korab Mermeri)
- gg) Vetëm disa kompani kanë strategji marketingu dhe investojnë në promovimin e prodhimeve të veta. (Gudallat)

3

Roli i rëndësishëm i emigrantëve

Emigracioni ekonomik i ashtuquajtur "Kurbet", ka traditë të gjatë si në vend ashtu edhe në Gostivar. Vala e emigracionit filloi në vitin 1960 dhe vazhdon deri sot. Emigron kryesisht popullata shqiptare e Gostivarit. Gjatë kohës së socializmit, Shqiptarët kryesisht nuk ishin pjesë të industrializimit. Nataliteti i lartë dhe mungesa e punës së garantuar përveç në bujqësi bashkë me integrimin e Perëndimit për fuqi të lirë pune, e nxiti emigrimin masiv të Shqiptarëve nga Gostivari. Ky interesim ende ekziston, por sot vështirë është të shkohet në vendet e huaja me pasaportë maqedonase. Por edhe përveç asaj shumë të rinjë nga Gostivari ëndërrojnë për ardhmëri dhe mundohen në mënyra legale dhe jolegale ta arrijnë deri në Europën Perëndimore dhe atje të gjejnë punë.

Sa emigrantë ka në Gostivar? Vështirë të gjenden të dhëna të sakta. Agjensia e emigracionit vlerëson se rreth 350000 banorë të Maqedonisë jetojnë në vende të huaja, kurse sipas Ministrisë së punëve të jashtme ai numër arin deri 800000⁷⁸. Edhe pse këto të dhëna janë jo të besueshme as Agjensia, as Ministria kanë të dhëna të sakta për emigrantët nga Gostivari. Të dhënat nga Minsitria e punëve të brendëshme, po ashtu nuk janë shumë të dobishme. Edhe pse çdo qytetar i Maqedonisë që mbetet jashtë shtetit më gjatë se tre muaj është i detyruar ta paraqesë qëndrimin e vetë në Ministrinë e punëve të brendëshme, në praktikë shumë pak qytetarë e bëjnë këtë. Për shembull, në vitin 2004 asnjë person nga Gostivari nuk është paraqitur në Ministri se ka emigruar. Të dhënat për emigrantë nga komuna

⁷⁸ Informatë fituar nga Seadin Xhaferi, zëvendës drejtor i Agjencionit për emigrim dhe Sashko Todorovski, udhëheqës i pjesës për emigrim në përbërje të Ministrisë për punë të jashtme.

Gostivar tregojnë në masivitet të këtij fenomeni. Gjatë kohës së regjistrimit në vitin 2002, 22995 banorë kanë qenë të regjistruar se banojnë jashtë shtetit për periudhë deri një vit, (shkak punë apo shkaqe të tjera) plus antarët e familjeve të cilët banojnë me ta.

Sipas të dhënave të mbledhura banorët e komunës Gostivar që janë pak më shumë se 4% nga popullata e përgjithshme në Maqedoni, kanë 3145 persona që është 15% prej të gjithë emigrantëve maqedonas⁷⁹.

Shqiptarët e përbëjnë shumicën e madhe të personave që banojnë jashtë shtetit, si në relacion të komunës Gostivar, ashtu edhe në relacion të gjithë vendit⁸⁰.

Tabela 10: Numëri i emigrantëve nga Maqedonia dhe Gostivari⁸¹

Numër i emigrantëve nga Gostivari	Vendi i banimit	Pjesë në numrin e përgjithshëm të emigrantëve maqedonas (gjithësej 22995)
1105	Itali	19%
902	Zvicër	15%
688	Gjermani	15%
288	Austri	22%
38	SHBA	4.6%
124	Vende të tjera	2.7%
3145	GJITHËSEJ	14%

Numri i emigrantëve nga komuna Gostivar është zmadhuar nga regjistrimi në vitin 2002. Sipas regjistrimit zgjedhor të Ministrisë për drejtësi, ka 59650 votues të cilët qëndrojnë në vendet e huaja për periudhë deri një vit, nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në Republikën e Maqedonisë

⁷⁹ Të dhëna nga regjistrimi në vitin 2002. Për qëllimin e këti hulumtimi bëmë kombinim prej të dhënave të komunës së vjetër Gostivar dhe të komunave Vrutok, Sërbinovo, Çegrane dhe Banica e poshtme që ishin përfshirë në komunën Gostivar me Ligjin e ri për ndarje territoriale prej vitit 2004. Burim: Ent për statistikë, regjistrimi viti 2002, libri 4-“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë me qëndrim në vendet e huaja”, Shkup, prill viti 2004, faqe 18,48,50,58,124,136.

⁸⁰ Rreth 62% nga numri i përgjithshëm i personave prej gjith vendit të cilët janë regjistruar se jetojnë në vendet e huaja janë me preardhje shqiptare.

⁸¹ Shih: Burimin nga fusnota 79.

që është 1742316⁸². Banorët e Gostivarit janë pak më pak prej 10% nga votuesit e regjistruar, të cilët qëndrojnë jashtë shtetit.

Tabela 11: Numër i përgjithshëm i votuesve të regjistruar që qëndrojnë jashtë shtetit, komuna Gostivar dhe gjithë vendi⁸³

Numri i votuesve të regjistruar në Maqedoni	Numri i votuesve që qëndrojnë jashtë shtetit	Numri i votuesve në komunën Gostivar	Numri i votuesve nga komuna Gostivar të cilët qëndrojnë jashtë shtetit
1742316	59650	69004	5690

Të dhënat tregojnë se numri zyrtar i emigrantëve të regjistruar nga Gostivari është rritur prej 3145 në vitin 2002 (duke i përfshirë edhe fëmijët edhe personat mbi 18 vjet) deri në 5890 sot (pa personat më të rinj se 18 vjet). Mirëpo, të dhënat nuk lejojnë të bëhet vlerësim i saktë për nivelin e emigrimit nga komuna Gostivar, sepse kanë të bëjnë vetëm për personat që qëndrojnë në vendet e huaja në periudhë jo më gjatë se një vit e nuk kanë të bëjnë për personat që kanë emigruar jolegalisht⁸⁴. Prandaj nuk është e mundur të jepet numër i saktë për gastërbajterët nga Gostivari. Sipas vlerësimit të ashpër të QHKP, ky numër lëviz prej 15000 deri 20000.

Për shumë ikja jolegale jashtë shtetit është shansi i fundit. Ka mënyra si të emigrohet me shmangien e sistemit. Ahmet Fetahi për shembull ofron shërbime ndërmjetësuese për persona që kërkojnë shengen viza të ndryshme⁸⁵. Ai proceson rreth 120 viza vjetore (35 persona nga Gostivari) dhe paguan për shërbimin prej 600 deri 1000 euro për banorë të Shkupit dhe 1500 deri 200 euro për banorët e Gostivarit. Banorët e Gostivarit janë të gatshëm të paguajnë më tepër, sepse shumë prej tyre kanë të afërm në

⁸² Shih: "Nëpërmjet telefonit dhe internetit deri te informata për të drejtë vote". Vreme, 5 maj viti 2006.

⁸³ Për komunën Gostivar të dhënat janë fituar nga Adem Osmani nga njësia gostivarase e Ministrisë për drejtësi.

⁸⁴ Sipas Seadin Xhaferit, zëvendës drejtor i Agjencionit për emigrim, trendi i emigracionit ekonomik jolegal nga komuna Gostivar është në rritje në vitet e fundit, kryesisht për shkak të procedurave të komplikuara për marrjen e vizave.

⁸⁵ Intervistë me Ahmed Fetahi, 3 prill viti 2006. Emri i vërtetë është ndërruar në kërkesë të bashkëbiseduesit.

Perëndim. BE është vend i premtuar për shumë njerëz nga Gostivari, thotë Ahmedi. Ky nuk është rast me njerëzit prej vendeve të tjera. Ahmedi thotë se shumica e njerëzve nga Gostivari që kërkojnë viza janë ose të rinjë, ose gra me fëmijë të vegjël të cilat provojnë të arrijnë te burrat e tyre që jetojnë në BE. Në rritje po ashtu është edhe organizimi i martesave me marëveshje për marrje të dokumentave për qëndrim legal apo leje pune⁸⁶.

Grafiku 12: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Migrime

- hh) Ka shumë migrime në komunë (fshat-qytet, Gostivar-Shkup). (Nenad Mickovski)
- ii) Mirëpo migrimi më dominant në Gostivar është migrimi ekonomik në Europën Perëndimore edhe kjo më shumë vlen për popullatën shqiptare.
- jj) As Agjensia për emigracion, as Ministria për punë të jashtme kanë të dhëna të sakta për numrin e emigrantëve nga Maqedonia, përkatësisht edhe nga Gostivari. E njëjta vlen edhe për Ministrinë për punë të brendëshme.
- kk) Sipas ndarjes së re territoriale të vendit në vitin 2004, qytetarët e komunës së re Gostivar përbëjnë pak më shumë se 4% nga popullata e përgjithëshme e Republikës së Maqedinisë, deri sa pjesa e tyre në numrin e përgjithëshëm të emigrantëve të regjistruar nga Maqedini arrin 15% (Enti për statistikë, regjistrim viti 2002)
- ll) Sipas drejtoriumit më të rri të votuesve, plotësuar dhe shpallur në maj të vitit 2006, nga Gostivari ka 5890 emigrantë të regjistruar (pa ata që s'kanë të drejtë vote, apo të cilët ende nuk e kanë fituar atë të drejtë). (Ministria për drejtësi)
- mm) Sipas vlerësimit të QHKP, numri i emigrantëve në Gostivar sillet mes 15000 dhe 20000.
- nn) Ekziston trend i mbledhjes familjare, gratë dhe femijë emigrojnë në vendet ku kanë emigruar burrat-baballarët.
- oo) Proçesi i emigrimit ekonomik është në rrjedhje dhe shënon rritje për shkak të vështirësive ekonomike dhe kyshteve të vështira sociale.

⁸⁶ Shih: "Alternativa Brengosëse e të Rinjve të Gostivarit", Fakti, 22 dhjetor viti 2005.

Gostivari i merr parasysh njerëzit e vet që kanë emigruar në vendet e huaja. Përveç sektorit të ndërtimitarisë që ishte sqaruar më lartë, emigrantët janë të rëndësishëm edhe për aktivitetet e tjera ekonomike në Gostivar. Ata vijnë në periudha të caktuara. Qyteti gjallëron në periudhën verore dhe gjatë kohës së festave të Vitit të Ri, kur emigrantët i vizitojnë miqtë dhe të afërmit e vet. Në atë periudhë nëpër rrugët defilojnë: Opele, Folsfagene, Audi, Forde, BMW, Krajslerë, Mercedesë dhe Alfa Romeo me targa gjermane, austriake, zvicerane apo italiane dhe çrregullimi i komuniukacionit matet vetëm me atë në Shkup gjatë kohës së fluksit të madh. Në periudhat e tjera të vitit Gostivari ngjet në “qytet të shpirtrave”⁸⁷. Kur vinë gasterbajterët nënshkruhen më së shumti marrëveshje, shiten më së shumti produkte, ndërtohen më shumë shtëpi dhe banesa, kafeteritë dhe restorantet bëjnë fitim më të madh, qendrat medicinale dhe dentistët privat kanë më tepër pacientë, pompat e benzës derdhen më së shumti benzin dhe nënkuptohet ka më shumë dasma.

Shumë emigrantë martohen gjatë qëndrimit të tyre të shkurtë në Gostivar. Vlerësohet se në verën e vitit 2005 janë organizuar rreth 1000 dasma në tre komunat Gostivar, Vrapçisht dhe Mavrovë-Rostushë. Duke ditur se shpenzimet për një dasmë mund të arrijnë edhe deri 20000 euro, në Gostivar dhe në komunat fqinje janë shpenzuar rreth 20 milion euro vetëm për dasma. Për shkak të mungesës së lokaleve e restoranteve shumë dasma janë të detyruara të shtyhen për vitin 2006⁸⁸. Numri mesatar i mysafirëve është rreth 500, kurse shumë restorante organizojnë më tepër se një dasmë në ditë. Argjendaritë, grupet muzikore dhe shitoret për fustane nisësh kishin fitim të mirë në verën e vitit 2005⁸⁹.

⁸⁷ Ekipa huluntuese e QHKP e vizitoi Gostivarin shumë herë gjatë vitit 2005 dhe në tre muajt e para të vitit 2006 si gjatë kohës së verës, ashtu edhe në periudhat tjera të vitit. Pa ditur se bëhet fjalë për qytetit e njejtë, njeriu lehtë mundet të ngatrohët dhe të mendojë se është në ndonjë vend tjetër.

⁸⁸ Shih: “Vera në pjesën perëndimore e Maqedonisë kalon në shënjën e krenimeve shtëpiake”, Utrinski Vesnik, 10 gusht viti 2005.

⁸⁹ Shih: “Pas trivjetori “dasmë abstenentë” Gostivari dy muaj vlon prej 600 dasmash”. Dnevnik, korik viti 2005.

Grafiku 13: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Ndihma në të hollat dhe roli kryesor i emigrantëve

- pp) Përfundimi i përgjithshëm është se Gostivari ka sukses të mbijetojë falë ndihmës në të holla (mjetet nga jashtë shtetit) dhe të hollat që emigrantët i shpenzojnë gjatë kohës së qëndrimit të tyre në qytet.
- qq) Vizitat e shumta janë gjatë kohës së verës, periudhë në të cilën përveç punëve të tjera ka edhe shpenzime të mëdha për dasma.
- rr) Të dhënat zyrtare për mjetet nga jashtë shtetit në nivel të shtetit dhe komunës janë të pamjaftueshme dhe bëjnë pjesë në sferën e spekulimeve.
- ss) Sipas vlerës së QHKP, mjetet nga jashtë shtetit në Gostivar lëvizin midis 25 dhe 33 milionë euro në vit.
- tt) Nuk ekziston strategji nacionale apo komunale për tërheqje dhe shpërndarje racionale të mjeteve nga jashtë shtetit.

Të hollat të cilat emigrantet i derdhin në qytetin apo në fshatrat e lindjes, ose mjetet të cilat i shpenzojnë apo investojnë gjatë qëndrimit të tyre të shkurtër kanë rëndësi të madhe për ekonominë e cila është në periudhë të post-tranzicionit siç është rasti me Maqedoninë. Vlera e mjeteve nga jashtë shtetit rritet kudo në botë në vitet e fundit.

Në disa vende emigruese mjetet nga jashtë shteti në vitin 2004 të cilat sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar kanë qenë 26 miliardë dollarë në gjithë botën, në shkallë të madhe i tejkalonin shumat e ndihmës për zhvillim, kurse në disa raste edhe shumën e investimeve të huaja apo të arrdhurat nga eksporti i mallit dhe shërbimeve⁹⁰. Maqedonia i takon këtij grupi të vendeve. Ministria Gjermane për punë të jashtme vlerëson se 70000 emigrantë maqedonas në Gjermani dërgojnë në Maqedoni rreth 50 milion dollarë në vit⁹¹. Enti i Zvicrës për statistikë ka të dhëna të ngjajshme. Të

⁹⁰ Shih: Migrime, Mjete nga vende të jashtme dhe zhvillim ISBN-92-64-013881 shpallur nga Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim. (OECD) viti 2005, faqe 9.

⁹¹ Shihe Ministrinë gjermane për punë të jashtme në internet faqen: [http://www.ausaeertiges-
amt.de/www/en/laenderifinos/laender/laender_ausgabe_html?type_id=14&land_id=110](http://www.ausaeertiges-amt.de/www/en/laenderifinos/laender/laender_ausgabe_html?type_id=14&land_id=110)

dhënat nga Fondi Monetar Ndërkombëtar tregojnë se mjetet nga shtetet të jashtme në vitin 2002 kanë qenë 15,2% nga bruto prodhimi maqedonas që është 278 dollarë per kapita⁹².

Tabela 12: Mjete nga shtetet e jashtme dhe investimet e huaja direkte në Maqedoni (në milion dollarë) (\$) ⁹³

Viti	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Mjete nga jashtë shtetit	13	34	42.5	64.2	66.2	47.4	69.8	130.2	146.3	155.3
Investime të huaja direkte	11.2	30	127.7	32.4	175.1	440.6	77.7	94.2	155.8	97

Një nga problemet gjatë hulumtimit të mjeteve nga shtetet të jashtme është vështirësia e përcaktimit të shumës së tyre të saktë, veçanërisht po të merret parasysh, se pjesë e madhe e të hollave dërgohen nëpër kanale joformale që nuk janë regjistruar në bankën qendrore, apo Ministrinë përkatëse⁹⁴. Pjesë e madhe e të hollave dërgohen ose nëpërmjet emigrantëve të cilët kthehen në shtëpi, ose nëpërmjet “korierëve” siç janë të afërmit, miqtë apo operatorët privat turistik apo shoferët e autobusëve. Kjo i përket edhe Maqedonisë ku shuma e të hollave që dërgohen nëpërmjet kanaleve joformale i tejkalojnë të hollat që dërgohen me transferta zyrtare. Për shembull, sipas disa të dhënave vetëm 15% nga të hollat që kanë qenë të derdhura në Maqedoni kanë qenë të derdhura nëpërmjet bankave, kurse pjesa tjetër nëpërmjet familjarëve apo miqve⁹⁵.

⁹² Shih: IMF, Balance of Payments Statistic Year Book (Libri vjetor për balancë të pagesave), viti 2003. Banka Botërore, indikatorë për zhvillimin botëror, viti 2003.

⁹³ Burim: Banka Nacionale e Maqedonisë, shih në internet faqen: <http://www.nbrm.gov.mk>

⁹⁴ Shih: Mjete ndërkombëtare nga jashtë dhe zhvillim: fakte ekzistuese, politika dhe rekomandime nga Inter-Banka Amerikane në zhvillim dhe Univerziteti në Sergi-Pontoas, janar viti 2006, by Amerikan Development Bank and Universite de Cergy-Pontoise

⁹⁵ “Potenciali financiar i emigrantëve dhe përfshirja e ti në ekonominë e Repunlikës së Maqedonisë”, Seadin Xhaferi, Shkup viti 2004.

Për atë edhe nuk kemi mundësi të japim numrat e saktë për shumat që derdhen në komunën Gostivar. Nëse supozojmë se shuma vjetore që një emigrant ia dërgon familjes së vet në Gostivar është 5000 euro që është një vlerë mjaft reale, ajo do të thotë se 15000-20000 emigrantë nga Gostivari dërgojnë 75-100 milion euro. Mirëpo, duhet të merret parasysh se numri i përgjithshëm i emigrantëve përfshin edhe gra edhe fëmijë. Ata nuk punojnë dhe nuk fitojnë të holla që do të thotë se numri i sipërm duhet të ndahet më së paku me tri. Por edhe në këtë rast arrijmë në një shumë të rëndësishme prej 25-33 milion euro të cilat çdo vit dërgohen në komuna Gostivar.

Por, ky trend mund të ndryshojë. Kërkesa në sektorin ndërtimor bie në vitet e fundit. Problemi është se shtëpitë e reja më shpesh ngelin të zbrasta edhe të pabanuara gjatë vitit dhe lehtë mund të vidhen. Vetëm në Gostivar ka rreth 1000 shtëpi që janë të zbrasta. Drejtori i Elektrodistribucimit të Gostivarit ankohet se ndërmarja ka probleme me përcjeljen e shpenzimeve të rrymës në familje⁹⁶.

Në të kaluarën burrat e pamartuar në moshë mes 18 dhe 35 vjet ishin gasterbajterët kryesor nga Gostivari, por viteve të fundit situata ndryshon. Mund të vërehet tendencë e lartë e “mbledhjeve familiare” dhe shpërngulje adekuate e grave e femijëve në vendet e jashtme. Të dhënat flasin se mjetet nga jashtë zbresin me rritjen e numrit të grave emigrante. Shumat që dërgohen po ashtu zvogëlohen, për shkak të vdekjes së njerëzve më në moshë, për shembull kur vdesin prindërit, djali që punon në shtetet e jashtme i dërgon shuma shumë të vogla vëllait të vet⁹⁷.

Ka më pak fëmijë që lindin e me atë edhe më pak emigrantë potencial. Keramidin Selimi, drejtor i SH.F. “Mosha Pijade” nga Gostivari thotë se në

⁹⁶ Intervistë me Brane Arsovski, drejtor i “Elektrodistribucimit” në Gostivar, 10 mars viti 2006.

⁹⁷ Intervistë me Seadin Xhaferin, zëvendës drejtor i Agjencionit për emigrim, 15 fror viti 2006.

disa vitet e fundit numri i nxënësve në shkolla është zvogëluar më së paku për 100⁹⁸.

Sipas Emini Gulceid, drejtor i Sh. F. “Petre Jovanovski” numri i nxënësve në atë shkollë fillore zvogëlohet për gati 100 ç’do vit⁹⁹. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve, shkolla fillore “Zlate Damjanovski” në fshatin Vrutok, duhet të organizojë orë të përbashkëta për nxënës të moshave të ndryshme¹⁰⁰.

Tabela 13: Numër i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore në komunën Gostivar në vitet e fundit¹⁰¹

Viti shkollor	Numri i nxënësve
1999-2000	12719
2000-2001	12870
2001-2002	12350
2002-2003	11937
2003-2004	11533
2004-2005	11137
2005-2006	11154

Në realitet nataliteti në komunën Gostivar është në rrënie të përhershme. Në vitin 2004 ishin lindur vetëm një e treta nga numri i bebeve lindur në vitin 1994. Për shkak të kushteve më të mira për jetë të emigrantëve, nuk befason fakti që ata kanë më tepër fëmijë nga miqtë dhe fisi në Gostivar. Në ç’do fëmijë lindur në Gostivar vinë dy fëmijë lindur në shtetet e jashtme me të paktën një prind që ka prejardhje nga ky qytet¹⁰².

⁹⁸ Intervistë me Keramidin Selimi, 23 mars viti 2006.

⁹⁹ Intervistë me Emini Gulceit, 23 mars viti 2006.

¹⁰⁰ Shih: “Kushtet kënaqin, numri i nxënësve bije”, Monitor 23 mars viti 2006.

¹⁰¹ Të dhëna fituar nga Goce Trajçevski, inspektor në inspektoratin Shtetëror për arsim të Gostivarit.

¹⁰² Në vitin 2004 Enti për statistikë i Republikës së Maqedonisë vuri kategori të re “me preardhje nga komuna e caktuar në Maqedoni, por të lindur në shtetet e jashtme”.

Tabela 14: Natalitet/mortalitet në komunën Gostivar në dekadën e fundit¹⁰³

Viti	Të lindur gjallë	Të vdekur	Rritje natyrore
1995	2516	727	1934
1996	2543	692	1851
1997	1526	498	1028
1998	1557	498	1034
1999	1333	537	796
2000	1464	516	948
2001	1376	556	820
2002	1423	611	812
2003	1390	552	838
2004	823	534	289

Ekziston rrezik se nëse gasterbajterët nga Gostivari nuk stimulohen të investojnë në aktivitete më të mbajtura ekonomike nga ndërtimi i shtëpive dhe konsumimi, ekzistimi i fotografisë socio-ekonomike mund të bëhet edhe më e erësuar.

Disi mund të diktohen disa sinjale shqetësuese. Gazmendi, ekonomist kryesor në firmën ndërmtime "Terapllan" thotë se gasterbajterët bëhen më dorështrënguar dhe në vend të ndërtojnë shtëpi ata blejnë banesa¹⁰⁴. Marijan Gjerkoviç, që ka shitore për shitje të kompjuterëve në qendrën e Gostivarit ankohet, se emigrantët që e vizitojnë Gostivarin në verë shpenzojnë më pak të holla prej më parë, sepse blejnë produkte nga

¹⁰³ Burim: Enti për statistikë, libri vjetor për vitin 1996, faqe 44 dhe 50, libër vjetor për vitin 1997 faqe 42 dhe 50, burim: libër vjetor për vitin 1998 faqe 42,43,68,70,72, libër vjetor për vitin 1999 faqe 44, 45, 46, 68, 70, 72, libër vjetor për vitin 2000 faqe 44,45, 46,68,70,72, libër vjetor për vitin 2001 faqe 44,45,46,68,70,72, libër vjetor për vitin 2002 faqe 44,45,46,68,70,72, libër vjetor për vitin 2003 faqe 44,45,46,68,70,71, libër vjetor për vitin 2004 faqe 44,45,46,68,70,72, libër vjetor për vitin 2005. Shkup, janar viti 2006, faqe 78 dhe 80.

¹⁰⁴ Intervistë me Gazmedin, ekonomist kryesor në "Terapllan", 17 gusht viti 2005.

Perëndimi¹⁰⁵. Ramadan Koçi, arsimtar i muzikës në Sh. F. “Goce Delçev” në Gostivar konsaton se më pak gasterbajterët e vizitojnë komunën Gostivar, përkundër viteve të kaluara¹⁰⁶. Rafet Jakupi, drejtor në ndërmarrjen komunale e dikton tendencën e dikushme të shpërnguljes së gjithë familjeve në shtetet e jashtme¹⁰⁷. Florim Saliu, menaxher në firmën ndërmtime thotë se sot emigrantët shumë shpesh i marrin familjet me vete, pa qëllim të kthehen përsëri në Gostivar¹⁰⁸.

Grafiku 14: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Rrënje e natalitetit

- uu) Rritja e numrit të banorëve në Gostivar në vitin 1995 ka qenë 1934. Në vitin 2000 ai ka rrënë deri në 948, kurse në vitin 2004 ka rrënë deri në 289. (Enti për statistikë).
- vv) Numri i nxënësve në shkollat fillore është vazhdimish në rrënjë Sh.F. “Moshë Pijade”, Sh.F. “Petre Jovanovski”, Sh. F. “Bashkim Vëllazërim”, Sh. F. “Zlate Damjanovski”
 - i) Numri i nxënësve ka rrënë prej 12719 në vitin shkollor 1999-2000 në 11154 në vitin shkollor 2005-2006. (Njësi teritoriale e inspektoratit shtetëror për arsim)
- ww) Sipas vetë banorëve, shkaqet kryesore për tendencën e këtillë janë restruktuimi i familjes shqiptare dhe para së gjithëash- dyndje mekanike e popullsisë.
- xx) Ekzistojnë shumë persona që janë regjistruar si të lindur në shtetet e jashtme, por me prejardhje nga Gostivari.
 - i) Numri i personave të tillë është në relacion 2/1 ndaj numrit të porsalindur në Gostivar (Enti për statistikë)

Mendimin e Florimit e vërteton edhe Iliaz Ameti, pronar i kompanisë për tregëti dhe prodhimtari të cevave sanitare¹⁰⁹. Sipas Iliazit në të kaluarën

¹⁰⁵ Intervistë me Marijan Gjurkoviç, pronar në shitore për kompjuterë dhe internet kafe, 27 qershor viti 2005.

¹⁰⁶ Intervistë me Ramadan Koçin, arsimtar në Sh. F. “Goce Delçev”, 12 gusht viti 2005.

¹⁰⁷ Intervistë me Rafet Jakupin, drejtor i “Gostivar”, 24 fror viti 2006.

¹⁰⁸ Intervistë me Florim Sali, menaxher i “Florida Sali”, 1 prill viti 2005.

¹⁰⁹ Intervistë me Iliaz Ametin, pronar i “Korab Komerc”, 27 tetor viti 2005.

është llogaritur për turp të shkohet në punë në shtetet e jashtme dhe të merren atje gruaja dhe fëmijët. Adis Bajratari, menaxher në Euro-Bodeni, kompani për përpunimin e granitit vlerëson se për shkak të stagnimit ekonomik të vendeve si Gjermania dhe Italia fuqia shpenzuese dhe dëshira e gastërbajterëve t'i shpenzojnë të hollat e veta në Gostivar është në rrënje të pandërprerë¹¹⁰. Përralla të njejta kanë qenë treguar nga 90% prej vetave të cilët QHKP i intervistonte për kohën e hulumtimit nëpër terene në komunën Gostivar.

¹¹⁰ Intervistë me Adis Bajratari, menaxher në "Euro-Granit", 3 gusht viti 2005.

4

Si të ringjallet ekonomia në Gostivar-krijimi i “kampionëve” dhe shëndrimi i mangësive në përparësi

Me qëllim që të kalohet nga ekonomia e cila është e kushtëzuar nga faktorë, në ekonomi që është kushtëzuar nga investimet, shteti pa tjetër të ndërmarë reformë. Për shembull, Maqedonia duhet t’i thjeshtësojë procedurat administrative siç janë liçencimi, për shkak se ato janë të papërshtatshme, të ngadalëshme dhe të paparashikueshme. Shpenzimet për punësim dhe lëshimi i të punësuarve janë relativisht të larta. Funkcioni i sistemit gjyqësor është edhe një dobësi në këtë kontekst. Më tej, korupsioni i imët paraqitet si problem serioz, veçanërisht në nivelet më të ulta të administratës. Proçesi i fitimit të lejes dhe liçencës është më i lehtë për ata që kanë “lidhje të mira”.

Joefikasiteti i sistemit për regjistrim të tokës është edhe një pengesë e madhe e investimit¹¹¹. Maqedonia duhet t’i zhvillojë tregjet financiare, të tërheqë investime të huaja, të importojë teknologji globale dhe njohuri që do t’i integrojë në ekonominë globale. Ç’mund të bëj Gostivari që t’i rrisë investimet direkte të huaja, të mundësojë hyrje të teknologjive dhe njohurive të reja në kompanitë lokale dhe t’i shpërblejë kuadrot ekzisuese që të mund të prodhojnë produkte cilësore?

¹¹¹ 2005, Raport analitik për mendimin e komisionit European për aplikimin e Maqedonisë për anëtare në UE, faqe 49

Cila është përparësia më e madhe e Gostivarit e cila mund ta mundësojë atë, me atë që ofron kapital, teknologjitë e reja, njohuri dhe lidhshmëri me tregjet e jashtme?

Gasterbajterët!

Hulumtimet tregojnë se mjetet nga jashtë ndikojnë mbi zhvillimit ekonomik global, zvogëlimin e varfërisë, ngritjes së nivelit të arsimit dhe investimeve¹¹². Qeveritë shpresojnë se mjetet nga jashtë do të ndihmojnë për rivendosje të lidhjes afatgjate në mes emigrantëve dhe vendit të tyre të lindjes që do të jetë e përcjellë me transfer të aftësive dhe njohurive fituar në tregjet e zhvilluara të vendeve të huaja¹¹³. Për atë qëllim, krijuesit e politikave nacionale shfrytëzojnë opsione të ndryshme për tërheqje dhe shfrytëzim adekuat të mjeteve nga jashtë. Shumica e emigrantëve që punojnë në shtetet e jashtme nga Gostivari “gasterbeiter” në gjuhë gjermane janë shqiptarë¹¹⁴. Mjetet të cilat ata i dërgojnë janë vitale për mbijetimin e familjeve të tyre. Mirëpo, ndikimi që ata e kanë mbi ekonominë në Gostivar mund të jetë edhe më i madh dhe më i gjerë prej vetë dërgimit të të hollave gjatë vitit dhe shpenzime të hollash për kohën e pushimeve.

Deri tani mjetet ndihmonin për ngritjen e standardit shtëpiak dhe zvogëlimin të varfërisë, por ata po ashtu mund të jenë burim kryesor për zhvillimin ekonomik dhe investimet e arrdhëshme. Në momentin pjesa më e madhe prej mjeteve nga shtetet e jashtme për Gostivarin nuk kontribuojnë për zhvillim më të mbajtur socio-ekonomik të komunës. Kryesisht ato shpenzohen për ndërtim të shtëpive dhe banesave dhe mjetet e tilla rrallë kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm mbi ekonominë lokale. Disa kompani prodhuese ishin të hapura nga ana e emigrantëve kthyes që i shfrytëzuan përparësitë teknologjike dhe njohuritë që i fituan në vendet e Europës

¹¹² Shih: Migrime, mjete nga jashtë dhe zhvillim, ISBN-92-64-013881 shpallur nga Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), viti 2005 faqe 286-298.

¹¹³ Ibid

¹¹⁴ Sipas Entit për statistikë 2970 nga numri i përgjithshëm i emigrantëve nga Gostivari janë shqiptarë dhe vetëm 89 janë maqedonë.

Perëndimore. Ata punësuan kuadër të stërvitur dhe i shfrytëzuan kontaktet të cilat i vunë prej më parë dhe në atë mënyrë i lidhën bizneset e veta me tregjet e jashtme dhe u bënë prodhues udhëheqës në Maqedoni. Prodhuesi i lëngjeve "Gudallat", prodhuesi i prodhimeve të qumshtit "Kaceifiçio Çezarina-Fejzi" (Caseificio Cesarina-Fejzi), prodhuesi i kamineve "Kamin", prodhuesi i dyerve dhe dritareve "Dino Profilli", prodhuesi i parketit "Muzo Kompani" dhe prodhuesi i dysHEMEVE të drurirt "Euro-Bodeni" janë emigrantë që janë kthyer në shtëpi dhe investuan në ekonominë lokale.

Shambuit e tyre tregojnë se emigrantët duhet të kontribuojnë për krijim të sektorit të mbajtur të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme në komunën Gostivar.

Siç tregojnë shembujt e lartpërmendur, sektori privat është ai që ka rol ta udhëheq procesin e zhvillimit ekonomik. Por, njësoj me rëndësi është që edhe qeveria të sigurojë korniza të cilat do t'ju mundësojnë kompanive të konkurojnë në tregjet ndërkombëtare. Nëpërmjet ndryshimeve të politikave vendet mundohen të krijojnë rreth biznesi më produktiv. Fazat e ndryshme të zhvillimit ekonomik kërkojnë modifikime të ndryshme të politikave dhe shkallë të pjesëmarrjes së qeverisë. Në secilin nivel të zhvillimit qeveria e ka detyrën të krijojë kushte për zhvillim të papenguar të sektorit privat.

5

Decentralizimi dhe roli i pushtetit lokal - rekomandime

Në ç'mënyrë mund institucionet lokale të ndihmojnë për revitalizimin e ekonomisë? Marrë në përgjithësi, besimi në qeverinë dhe institucionet e saj është shumë i vogël në Maqedoni, ku 52% nga qytetarët nuk kanë besimi në qeverinë¹¹⁵. Proçesi i decentralizimit përfaqëson koncept ku administrata komunale nëpërmjet shërbimeve që i ofron, fiton vlerë në sytë e qytetarëve.

Kjo duhet të sjell ndryshim të asaj që administrata ka qenë më parë e shikuar nga ana e publikut, ku korumpimi është llogaritur si punë normale¹¹⁶. Decentralizimi në Maqedoni u jep pushtet më të madh grupeve shoqërore, krijon mundësi që qytetarët t'i shprehin nevojat e veta i përfshin qytetarët në mënyrë aktive në proçesin e sjelljeve të vendimeve, ofron shërbime të cilat e përfshijnë gjithë popullatën, për shembull bazuar në gjininë, në përkatësinë kulturore, mosha apo aftësitë. Në fund decentralizimi rezulton në shërbime të orientuara nga klientët.

Ky zhvillim mund lehtë të vërehet në hulumtimin tonë. Pas shumë vitesh mospërfillje nga ana e krijuesve të politikave nacionale dhe udhëheqje jopërkatese nga ana e pushtetarëve komunal, komuna Gostivar shkante nëpër vijën e poshtme. Qeveria lokale kishte borxhe të mëdha¹¹⁷, higjiena

¹¹⁵ UNDP-Raport për paralajmërim të hershëm, mars viti 2006

¹¹⁶ UNDP-Raport për paralajmërim të hershëm, mars viti 2006 - 90% nga qytetarët mbesojnë se ka korumpim dhe keqpërdorje të fondeve shtetërore/publike në Maqedoni.

¹¹⁷ Llogaria ishte blokuar dhe borxhi i akumuluar ishte llogaritur në rreth 3 milion euro, prej të cilave 7000 euro ishte borxh ndaj njerës prej kompanive ndërmtimore më të mëdha në Maqedoni "Granit".

ishite e keqe, komunikacioni kaotik, rrugët e shkatëruara, kurse qyteti përplot me objekte të ndërtuara pa leje.

Në pranverën të vitit 2005 u mbajtën zgjedhje lokale në Maqedoni. Për prefekt të ri të Gostivarit ishte zgjedhur Nevzat Bejta nga BDI-ja. Prefekti ishte ballafaquar me mbetjet nga puna e paraardhësve të tij dhe nxitjet e procesit të decentralizimit që duhej të fillontë në korrik të vitit të njejtë. Në vitin e fundit ai pati sukses të përballet me problemin e borxhit dhe përsëri t'i hap llogaritë komunale, investonte 2 milion euro në projekte komunale, i rreguloi rrugët, komunikacionin, higjienën dhe planifikimin urban të qytetit me largimin e 856 objekteve, prej të cilave 735 ndërtime pa leje, kurse të tjerat të ndërtuara me "leje të përkohësishme"¹¹⁸.

Prefekti i ri po ashtu e përmirësoi transparencën në punë e pushtetarëve komunal me hapje të internet faqes në të cilën publikohen të gjitha dokumentet, lajmërimet dhe rrisitë. Ky orientim të afrohet komuna, shërbimet të cilat ajo i ofron deri te qytetarët, reflektohet edhe në sjelljen e sistemit njësportel për regjistrimin e bizneseve të reja, sistem ku qytetarët mund t'i fitojnë në një vend të gjitha lejet e nevojshme si formulare, vërtetime për pronësi e të tjera, si dhe t'i paguajnë taksat e nevojshme komunale¹¹⁹.

Mirëpo, të gjitha intervenimet e deritashme të prefektit dhe ekipit së tij kanë qëllim për sjelljen e rendit dhe përmirësimin të infrastrukturës në komunë. Pak prej tyre sillen në mënyrë direkte në përmirësimin e rrethit për zhvillim ekonomik. Që të bëhet ajo komuna më parë duhet të ketë strategji për zhvillim ekonomik lokal që do të ishte bazuar në analizë të potencialeve ekonomike dhe nevojave të vërteta të qytetarëve. Duke patur parasysh se kapacitetet për analizë dhe planifikim të administratës lokale janë shumë të kufizuara nuk ekziston planifikim afatgjatë që do ta kishte ndihmuar zhvillimin dhe do t'i kishte përcaktuar prioritetet.

¹¹⁸ Shih: "Programi 4-vjetor parazgjedhor është realizuar më shumë se 100% gjatë 1 viti". 10 prill viti 2006 në <http://www.gostivari.gov.mk/mac/index.asp?Url=Neës&Id=76>

¹¹⁹ Shih: "Komunë me një sportel në Europë", Vreme 20 nëntor viti 2005.

Proçesi i krijimit të politikave në nivel komunal është i mbylur në masë të madhe për qytetarët të cilët nuk thiren në sesione konsultative, kur bëhet zgjidhja për pyetje të tilla, siç është buxhëti.

Grafiku 15: Kampionët e ekonomisë gostivarase

“Gudallat” është një nga shembujt e rallë të emigrantë-kthyesve të cilët vendosën të fillojnë biznes serioz në vendlindje. Fabrika është pronësi e familjes Fetai, babai Miradi dhe djali Fetai. Në 1980-tat ata kanë qenë ko-pronarë dhe ko-menaxherë në fabrikë për lëngje në Zvicër nën emrin “Gudallat”. Në vitin 1998 hapet filiali gostivaras i “Gudallat” dhe prodhimi zyrtarisht fillon në vitin 1999 në fabrikë me teknologji të re dhe më të zhvilluar ndërtuar në periferi të qytetit. “Gudallat” ka 55 të punësuar dhe është një nga punëdhënësit më të mëdhenjë në Gostivar. “Gudallat” është fabrika e vetme për përpunim të frutave në Ballkan e cila i plotëson edhe BRS standardet për kualitet. Kompania investon shumë (5-10% nga qarkullimi i vet) në fushata promovuese dhe reklamim të prodhimeve të veta. Prej vitit 2004 Gudallat filloi t’i punesojë studentët më të mirë nga Univerziteti i Europës Jug-Lindore në Tetovë. E ngjajshme është edhe përralla e “Caseificio Cesarina” që prodhon sorta të ndryshme të kashkavallit dhe djathit dhe prodhime të tjera qymështi. Nagip Fejziu nga Gostivari u shpërngul në Itali dhe u punësua si punëtor i thjeshtë në fabrikën e prodhimeve të qymështit “Caseificio Cesarina” në afërsi të Romës. Shpejt përparon prej punëtorit të thjeshtë në supervisor. Në ndërkohë fabrika filloi të ketë probleme financiare dhe Nagipi ndërmori rrezik me atë që vendosi të investojë të hollat e veta në fabrikë dhe e bleu paketin menaxhues. Tani fabrika në Itali ka 9 të punësuar prej të cilëve 3 janë nga Gostivari. Në vitin 2001 Nagipi vendosi të investojë dhe të hapë fabrikë për prodhime të qymështit në vendlindjen e vet Bellovishte në komunën Gostivar. Edhe pse kompania është e regjistruar nën emrin “Caserificio Cesarina”, ajo është shumë më e njohur në Maqedoni nën emrin “Fejzi”. Përveç fabrikës për prodhime të qymështit në Bellovishte, kompania ka edhe shitore, një në qendër të Gostivarit dhe një në qendrën e Shkupit. Fabrika në Itali prodhon vetëm për tregun italian, kurse fabrika në Bellovishte vetëm për tregun maqedonas. Por, planet për depërtim në tregjet e jashtme veç janë përgatitur dhe pronari vetëm pret leje nga Ministria për shëndetësi për eksport të prodhimeve të qymështit që janë prodhuar në Maqedoni. Kompania ka qëllim së shpejti të fillojë me ndërtim të fabrikës së re dhe të përkryer në Gostivar e cila pritet t’i përmirësojë kapacitetet prodhuese edhe të hap vende të reja pune.

Planifikimi jopërkates i zhvillimit të komunës mund po ashtu të vërehet edhe gjatë analizeës së buxhetit. Ajo është “vijë pas vije” tip i buxhetit. Është e njohur se programi buxhetor u konvenon qeverive lokale të cilët janë orientuar kah përmirësimi i zhvillimit, për arsye se i bazon shpenzimet vetëm mbi programe pa marrë parasysh objekte apo njësitë organizuese. Buxheti i programuar eksplicit i projekton shpenzimet programore afatgjate dhe evoulimin e alternativave programore të ndryshme të cilat mund të jenë të shfrytëzuara për arritje të qëllimeve afatgjata.

Buxheti ekzisues i Gostivarit përfshin vetëm investime kapitale në infrastrukturën komunale (të gjithë 19 projektet e komunës janë planifikuar për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit, kanalizimit dhe kapacitetet e deponive). Kjo e vërteton atë që është thënë më lartë se komuna i përcakton prioritetet vetëm për infrastrukturën e jo për zhvillimin ekonomik.

Mungesa e kapacitetit për përcaktim të pavarur të prioriteteve komunale për zhvillim ekonomik dhe ndërmarje e iniciativës në këtë fushë është nxitje edhe nga ajo që komuna është shfrytëzuese e projekteve donatore në bashkëpunim me pushtetin qëndror (siç është projekti i UNDP-së “Ndërmjetësim për punësimin e kuadrit të ri me arsim të lartë”), por asnjëherë nuk paraqitet si partner implementues apo si lidër apo si iniciator për atë që mund ta përmirësojë situatën ekonomike në komunë.

Grafiku 16: Indikatorë për gjendjen në komunën Gostivar

Zbatim i pamjaftueshëm i mundësive që dalin nga proçesi i decentralizimit

- yy) Para vitit 2005 komuna ishte në borxhe të mëdha, higjiena ishte në nivel të paknaqshëm dhe të ulët, kishte ç’regullime të mëdha të komunikacionit, rrugët ishin shkatëruar dhe ndërtimtaria jolegale ishte në lulëzim të plotë.
- zz) Pas vitit 2005, prefekti i ri pati sukses ta deblllojë llogarinë e komunës dhe të investojë mbi 2 milion euro në projekte komunale duke e rregulluar gjendjen me rrugët dhe komunikacionin, higjienën dhe planifikimin urban.
- aaa) Po ashtu ai e bëri punën e administratës lokale më transparente dhe bëri internet faqe ku shpallen dokumente të ndryshme, deklarata dhe lajme.
- bbb) Mirëpo të gjithëa përpjekjet e deritashme janë kahëzuar kah vendosja e rendit publik dhe përmirësimi i infrastrukturës e jo kah krijimi i zhvillimit të mbajtur
 - i) Nuk ekziston planifikim afatgjatë më drejtim të nxitjes së zhvillimit.
 - ii) Ende nuk janë caktuar prioritetet zhvilBEse.
 - iii) Buxheti lokal ka strukturë të vjetruar, komponentet zhvilBEse kanë formë të investimeve kapitale e jo në programe ekonomike afatgjate.
- ccc) Proçesi i sjeljes së vendimeve në nivel komunal është pa pjesëmarrje më të gjerë dhe të drejtpërdrejtë të qytetarëve.
- ddd) Gostivari është shfrytëzBEs i donacioneve të huaja që implementohen nëpërmjet projekteve. Mirëpo, komuna është e përfshirë në këto projekte vetëm si nënshtrBEse e pushtetit qendror, më ralë si partner e gati asnjëherë si iniciator.

Për komunën Gostivar është shumë me rëndësi të sugurojë klimë që do ta kishte nxitur zhvillimin ekonomik në rajon. Që të bëhet ajo pushtBEsit lokal duhet të sjelin zgjidhje për prioritetet strategjike të komunës, të zhvillojnë plan për ekonomi mbindërtimore dhe të përvetësojnë programe dhe masa që t’i arrijnë qëllimet ekonomike të komunës. Komuna duhet po ashtu të mos kufizohet në përpjekjet e veta kah tërheqja e investimeve të drejtpërdrejta të huaja për mes bizneseve të jashtme, se pse ajo hap vende pune të reja dhe e zvogëlon papunësimin. Gostivari deri në

maksimum duhet ta shfrytëzojë potencialin e emigrantëve të vet të sjellin në shtëpi njohuri, teknologji të re edhe kapital dhe ta çojë para ekonominë e vet, prej e kushtëzuar në e kushtëzuar nga investime. Që të arihen këto qëllime, Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politikë rekomandon disa iniciativa.

Për krijim të rajonit më tërheqës për firma të reja dhe ekzistBese

- Komuna duhet të shfrytëzjë iniciativa fiskale për mes shfrytëzimit të taksave diskrecione lokale, veçanërisht tatimet e parurisë dhe sjeljen e taksave komunale të përshtatshme për aktivitetet e reja ekonomike që do të prodhojnë prodhime me vlerë të madhe goditse.
- Duhet të zhvillohet toka për shembull me zbatimin e sistemit bankash (and banking) (blerje dhe përmirësim i parcelëve fqinjësore), konsolidim i parcelave dhe përmirësimi i infrastrukturës me qëllim që të krijohen si përfaqe të mëdha të përshtatshme për investim.
- Duhet të organizohet shitje apo dhënje me qira në vendet më të mira nëpërmjet marketingut të investBESit potencial.
- Nëse tërhiqen kompanitë të mëdha, atëhere atyreve do t'i duhen vende përkatëse me komunikim të mirë. Në atë rast infrastruktura lokale dhe rajonale bëhen prioritete kryesore.

Zmadhimi i nivelit të kapacitetit/arsimi i kuadrove në komunën dhe pushteti lokal

- Duhet të sillet analizë e politikës dhe njësi për vlerësim në kornizat e pushtetit lokal.
- Duhet të zmadhohen kapacitetet e përfaqësuesve të pushtetit lokal nëpërmjet të treningjeve dhe stërvitjeve të veçanta për zhvillim ekonomik lokal. Këto treningje dhe stërvitje duhet të logariten si pjesë nga puna e jo si mundësi të largohet e njëjta.
- Duhet të zhvillohet sistem personal i vlerësimit të kualitetit të të punësuarve, duke i marë parasysh parasëgjithëash aftësitë edhe përvojën e jo diplomat.
- Duhet të përkrahet iniciativa për përmirësim të kualifikimeve të dorës punës lokale, për shembull me identifikim të fushave ku është i nevojshëm trajning i specializuar për kënaqje të nevojave në tregun e dorës punës dhe të promovohen aktivitete arsimore nëpërmjet partnerëve publik dhe privat.
- Ngjajshëm, të investohet në aftësitë të marketingut të biznesmenëve lokal.
- Duhet të përkrahen qytetarët e Gostivarit të fitojnë arsim të lartë nëpërmjet bursave që do të ishin të financuara nga komuna dhe privat, kompani novative (shembulli me “Renova” nga Tetova); transport në relacion deri te Univerzitetet në Tetovë dhe Shkup; punësim i studenteve më të mirë në Gostivar (shembulli i “Gudallatit”)

Rritje e zhvillimit të përgjithëshëm ekonomik

- Duhet të krijohet strategji për zhvillim lokal ekonomik e cila do të ishte përcjellë me plan realist të aktiviteteve.
- Duhet të filohet me buxhet programor.
- Duhet të vendoset bashkëpunim me komunën Tetovë për promovimin e rajonit dhe ndërtim i klimës më të mirë për investim.
- Duhet të realizohet fushatë kundër ekonomisë joformale.
- Duhet të ndërmirëtohet roli i katalizatorit në partnerizim për zhvillim ekonomik me atë që do të mblidhen të gjithë pjesëmarrësit bashkë dhe do të mobilizohen resurset lokale për mbështetje të zhvillimit ekonomik. Strategjitë për zhvillim lokal ekonomik nuk guxojnë të jenë të përdorur pa bashkëpunim të afërt me pjesëmarrësit e tjerë. Bashkëpunim përmes sektorëve do të thotë pjesëmarrje e sektorit privat, qeveritar dhe atë pa përfitim.
- Duhet të promovohet partnerizimi dhe bashkëpunim mes ndërmarjeve të vogla dhe të mesme, si në korniza të një sektori, ashtu edhe mes sektorëve të ndryshme. Të silllet kllasteringu në nivel rajonal.

Promovim, apo “Reklamimi i komunës”

- Duhet të promovohen kampionët si shembuj më të mirë dhe ndikim mbi investimet të ardhshme nga ana e emigrantëve (shfrytëzim i sukseseve të “Gudallat” dhe “Fejzi” gjatë promovimit të Gostivarit si destinacion për investim të emigrantëve-kthyes).
- Duhet të zbatohet fushatë agresive promovBEse “e marketingut dhe reklamBEse” në Gostivar për promovim të bizneseve lokale dhe tërheqjeje e investitorëve të jashtëm. Përdorim i materialit të shtypur

(libra, broshura, prospekte) si mjete plotësBEse të mjeteve elektronike (internet faqe dhe kompakt disqe).

- Duhet të mirët pjesë në panairët të specializuara për pasuri të patundshme, konferenca për zhvillim dhe forume investBEse me informata të përgatitura për mjedisin lokal ekonomik, inventar i tokës dhe objekteve që janë në dispozicion, karakteristika të vendit (lidhje transportBEse, infrastrukturë) dhe informata për regulativat e planit.
- Duhet të hapen zyrat si përmarës dhe dhënje informatash, ku kompanitë do të mundën t'i fitojnë informatat, licencat dhe dokumentet e nevojshme.

PushtBEsit lokal duhet poashtu t'i analizojnë edhe rethanat dhe munden të:

- Ta japin pasurinë lokale si garancë për hua nga ana e ndërmarrjeve lokale apo ndërmarrjet e reja të gastërbajterëve gostivaras dhe të jenë garantBEs për hua në raste kur janë të nevojshme garancione juridike.
- Të hapin fonde garantBEse rajonale për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe t'i shfrytëzojnë resurset e këtyre fondeve për mbulesën e pjesës nga kreditë. Pagesat të gatshme nga privatizimi i pasurisë shoqërore mundet të shërbejnë si burim i resurseve për këto fonde garantBEse.
- Të zhvillojnë beznis parqe apo beznis inkubatorë me ofertë të shërbimeve të ndryshme që do t'ju kishin ndihmuar ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zhvillimin e tyre. Beznis inkubatorët mundësojnë resurse dhe sipërfaqe të përbashkëta të cilat ndërmarrjet e reja individuale vështirë mundet t'i gjejnë. Sipërfaqet e këtilla shpesh ndërtohen në tokë komunale apo krijohen si rezultat i restaurimit të objekteve të caktuara.

Rekomandime për pushtetin qëndror:

- Të sillet kornizë nacionale për mësim të përhershëm.
- Të reformohet arsimi i kahëzuar si do t'i kishte dalë në takim nevojave të tregut të dorës punBEse.
- Të ndrohet idea për Maqedoninë si vend i rrezikshëm për investime dhe të promovohet si destinacion i suksesshëm për investime.
- Të promovohet politikë për tërheqje dhe shfrytëzim të mjeteve nga jashtë.
- T'ju lehtësohet procedura për blerje dhe shitje të tokës shtetërore investBEse në kornizat të komunës.